



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera -  
Office of the Prime Minister

# **RAPORTI I PARË PËR ZBATIMIN DHE REZULTATET E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM 2016–2021**

Tetor 2018

# MIRËNJOHJE

Ky raport është përgatitur nga Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit bazuar në të dhënat e ofruara nga ministritë përkatëse që kanë përgjegjësinë në aktivitetet e planifikuara në Udhërrëfyesin për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Për hartimin e këtij raporti ka kontribuar edhe Projekti 'Mbështetje për Zyrën për Planifikim Strategjik', i financuar nga Bashkimi Evropian. Gjithashtu, përafrimi në këtë dokument me caqet e Agjendës 2030 dhe publikimi i këtij raporti është mundësuar me mbështetjen e dhënë nga Zyra e koordinatores për zhvillim të OKB-së dhe agjencive të OKB-së që operojnë brenda strukturës koordinuese të UNKT-së në Kosovë.

# PËRMBAJTJA

<b>AKRONIMET</b>	<b>3</b>
<b>1. VLERËSIM PËRMBLEDHËS</b>	<b>4</b>
1.1. Zbatimi i masave	4
1.2. Progresi drejt arritjes së objektivave kryesore të SKZH-së	6
1.3. Rezultatet e matjes fillestare	9
<b>2. ZBATIMI DHE REZULTATET E SKZH</b>	<b>10</b>
2.1. Shtylla 1: Kapitali njerëzor	10
2.2. Shtylla 2: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit	14
2.3. Shtylla 3: Industritë konkurruese	18
2.4. Shtylla 4: Infrastruktura	24
<b>3. PLANIFIKIMI FINANCIAR DHE RAPORTIMI</b>	<b>31</b>
3.1. Procesi i kostimit të masave të SKZH-së	31
3.2. Raportimi mbi shpenzimet e zbatimit të masave të SKZH-së	31
<b>4. HARMONIZIMI I OZHQ-së ME SKZH-në</b>	<b>33</b>
4.1. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm: Aplikimi global dhe ndërkombëtar	33
4.2. Harmonizimi i synimeve të OZHQ me SKZH	33
4.3. Disponueshmëria e të dhënave për të matur progresin e OZHQ-së	36
4.5. Kontributi i SKZH-së në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm	37
<b>5. HAPAT E ARDHSHËM</b>	<b>43</b>
5.1. Përmirësimi i zbatimit	43
5.2. Përmirësimi i marrëveshjeve të monitorimit dhe raportimit	46
5.3. Përmirësimi dhe ristrukturimi i masave ekzistuese të SKZH	47
<b>SHTOJCA I. TABELA E MONITORIMIT STRATEGJIK</b>	<b>53</b>
<b>SHTOJCA II. TABELA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT</b>	<b>55</b>
<b>SHTOJCA III. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE PËR OZHQ-TË DHE CAQET E HARMONIZUARA ME SKZH</b>	<b>62</b>

# AKRONIMET

PRE	Programi i Reformave Ekonomike
IHD	Investim i huaj direkt
PVPQ	Plani Vjetor i Punës i Qeverisë
BPV	Bruto Produkti Vendor
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016–2021
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
OZHQ	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

# 1.

## VLERËSIM PËRMBLEDHËS

**K**y është raporti i parë që shqyrton zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Zhvillim 2016-2021, në tekstin e mëtejshëm 'SKZH'. SKZH u miratua nga Qeveria e Kosovës në janar të vitit 2016 dhe përfshinte 34 masa të organizuara nën katër shtylla, me deri në shtatë aktivitete konkrete të zbatimit për secilën masë. Një plan më i detajuar i zbatimit - udhërrëfyesi i SKZH - që përfshin një kostim të masave dhe treguesve për zbatim dhe rezultatet, u përgatit në gjysmën e parë të vitit 2017. Ky raport bazohet në udhërrëfyesin e SKZH-së dhe metodologjinë për raportim dhe monitorim të zbatimit, rezultateve dhe financimit të SKZH-së, që u zhvillua nga Zyra e Planifikimit Strategjik. Ai raporton mbi gjendjen e zbatimit në fund të vitit 2017 dhe përdor vlerat e rezultateve të treguesve në dispozicion gjatë muajit qershor 2018.

Ky kapitull ofron një vlerësim përmblendhës që përshkruan mbulimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve) brenda SKZH-së, progresin e arritur gjatë dy viteve të para të zbatimit të SKZH-së. Vlerësimi përmblendhës përcillet nga dy raporte të detajuara për secilën shtyllë të SKZH-së (kapitulli 2); një diskutim i sfidave të raportimit mbi zbatimin financiar (kapitulli 3); dhe një shqyrtim i progresit të bërë përgjatë masave të ndryshme të SKZH-së ndaj synimeve të harmonizuara të OZHQ (kapitulli 4). Kapitulli përmbysllës ofron rekomandime për përmirësimin e zbatimit dhe monitorimit të SKZH dhe përmirësimin e masave ekzistuese.

### 1.1. Zbatimi i masave

Zbatimi ka filluar për të gjitha masat e SKZH-së, me përjashtim të një mase, edhe pse janë regjistruar vonesa për 25 përqind të aktiviteteve të planifikuara. Këto vonesa kanë ndikuar në afatin kohor të 15 masave. Megjithatë, progres i avancuar tashmë është shënuar në gjashtë masa dhe 24 përqind të të gjitha aktiviteteve, me një shtesë prej 7 përqind të aktiviteteve të përfunduara. Këto janë konsideruar si rezultate të mira për dy vitet e para të periudhës gjashtë vjeçare të zbatimit (2016-2021).

#### Shtylla 1: Kapitali njerëzor

Masat e Shtyllës 1 përqendrohen në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe lidhjen më të mirë të arsimit me nevojat e tregut të punës. Progres i fuqishëm është arritur tashmë në fusha të rëndësishme, siç është zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe futja e provimeve kombëtare të studentëve që matin arrijtjet e të nxëniet. Zhvilli i një sistemi informativ arsimor pothuajse ka përfunduar. Përmirësimi i inspektimeve shkollore po ashtu është avancuar, siç janë përmirësuar edhe zbatimet në inspektimet e tregut të punës dhe marrëveshjet e ndërlidhura për reduktimin e punësimit joformal.

Vonesat e vërejtura nën këtë shtyllë janë kryesisht të lidhura me ndryshimet sistematike dhe zhvillimin institucional. Agjencia për Standarde dhe Vlerësim nuk është themeluar, pasi që Qeveria e Kosovës, në kuadër të agjendës më të gjerë të reformës së administratës publike do të ndërmarrë një shqyrtim të agjencive ekzekutive, ndërsa kapaciteti dhe autonomia profesionale e Agjencisë Kombëtare të Kualifikimeve dhe Agjencisë Kosovare për Akreditim duhet të përmirësohen. Zbatimi i një sistemi të notimit dhe licencimit të mësimdhënësve nuk ishte filluar në vitin 2017. Mjetet kyçe për zhvillimin e arsimit profesional, si p.sh. për aftësitë e parashikimit dhe rishikimit të formulës së financimit, janë vonuar. Së fundi, pak është bërë deri më sot për të tërhequr ekspertë dhe studentë nga diaspora në sistemin arsimor kombëtar.

### **Shtylla 2: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit**

Në kuadër të Shtyllës 2, është shënuar progres i theksuar në fushat e rëndësishme të efikasitetit gjyqësor dhe prokurimit publik. Regjistrat e shërbimeve publike dhe procedurat administrative janë përfunduar dhe tani do të përdoren për të zvogëluar ngarkesat administrative për qytetarët dhe bizneset.

Vonesat lidhen me prezantimin gjithëpërfshirës të vlerësimeve të ndikimit rregullativ dhe me forcimin e sistemit të të drejtave pronësore (duke përfshirë thjeshtësimin e procedurave të regjistrimit të pronës, rritjen e kapacitetit të gjykatave për të vendosur mbi çështjet e të drejtave pronësore, dhe sigurimin e të drejtave pronësore të grave dhe anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë). Sa i përket inspektimeve, progres është arritur drejt përmirësimit të bashkëpunimit midis autoriteteve të inspektimeve, atyre tatimore dhe doganore. Megjithatë, përgatitja e legjislacionit për një sistem të unifikuar të inspektimeve është vonuar dhe bashkimi i planifikuar i autoriteteve tatimore dhe doganore nuk konsiderohet më prioritet qeveritar.

### **Shtylla 3: Industritë konkurruese**

Masat e Shtyllës 3 janë duke u zbatuar në masë të madhe në përputhje me afatet e planifikuara. Shumica e aktiviteteve të masave të synuara për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) dhe zhvillimin industrial (d.m.th., përmirësimin e qasjes në financa, mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve dhe grupimeve industriale me vlerë të lartë të shtuar dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD-ve) tashmë janë në fazën e avancuar të zbatimit.

Megjithatë, do të nevojiten përpjekje më të forta për të përkthyer përmirësimet në kushtet kornizë në rritje aktuale të IHD-ve dhe formim efektiv të grupimeve. Skemat mbështetëse për investimet e diasporës, NVM-të inovative, dhe sektorin e teknologjisë informative duhet ende të zbatohen ose forcohen. Ngjashëm, modeli i përzgjedhur dhe i përcaktuar me ligj për rivitalizimin e Trepçës dhe zgjidhjen e detyrimeve të saj nuk është zbatuar ende.

## Shtylla 4: Infrastruktura

Zbatimi i masave të Shtyllës 4 ka filluar, me vonesa të regjistruara për shumicën e masave. Progresi i avancuar është arritur drejt ndërtimit të infrastrukturës rrugore dhe përmirësimit të infrastrukturës për prodhim bujqësor dhe për biznese. Në sektorin e energjisë, është shënuar progres i mirë në kornizën ligjore për një treg të hapur të energjisë, eficiencës së energjisë dhe përdorimit të burimeve të ripërtërishme, me disa projekte që janë në proces. Përderisa ka vonesa në reformën strukturore të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe krijimin e kompanive ESCO, marrëveshja me investitorin privat për kapacitetin e ri prodhues (Kosova e Re) është tani në fyzën përmbyllëse.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore (p.sh., uji dhe pyjet) kanë filluar dhe është shënuar progres fillestar. Megjithatë, janë regjistruar vonesa në disa projekte të zgjerimit të ujësjellësit dhe më së shumti në menaxhimin e mbeturinave.

### 1.2. Progresi drejt arritjes së objektivave kryesore të SKZH-së

Një grup treguesish të nivelit makro është përzgjedhur për të monitoruar progresin drejt objektivave kyç të SKZH-së lidhur me rritjen, punësimin dhe kohezionin social. Tabela 1 paraqet vlerat bazë, objektivat, shifrat më të fundit në dispozicion dhe statusin e progresit ndaj këtyre treguesve.

Gjatë dy viteve të para të zbatimit të SKZH-së, punësimi dhe kohezioni social shënuan përmirësimin më të theksuar në të gjithë treguesit e nivelit makro. Prej tetë treguesve të përzgjedhur nga SKZH në fushën e punësimit dhe kohezionit social, dy tregues - një në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe tjetri në normat e varfërisë - janë arritur plotësisht; janë arritur plotësisht;<sup>1</sup> një tregues karakterizohet se ka progres të avancuar; dhe dy të tjerë kanë shënuar progres mesatar. Në anën tjetër, nga tre treguesit e përzgjedhur në fushën e rritjes ekonomike, është arritur progres mesatar tek një tregues dhe progresi i kufizuar është vërejtur në dy të tjerët. Së fundi, nga pesë treguesit e përzgjedhur në fushën e investimeve dhe tregtisë, një tregues karakterizohet të ketë progres të avancuar, një ka evidentuar progres mesatar, një ka treguar progres të kufizuar dhe një nuk ka treguar progres.

Rritja, investimi dhe tregtia: Gjatë periudhës 2015-2017, bruto produkti vendor (BPV) u rrit mesatarisht rreth 4 përqind në vit, por me progres të kufizuar drejt objektivit prej 7 përqind. Rritja ishte nxitur kryesisht nga konsumi privat dhe investimet (nxitur edhe nga investimet në sektorin privat, që u rritën nga 17.9 përqind e BPV në vitin 2015 në 19.7 përqind e BPV në vitin 2017),<sup>2</sup> ndërsa konsumi qeveritar kishte një ndikim negativ në rritjen e përgjithshme ekonomike. Rritja në konsumin privat ishte nxitur nga rritja e vazhdueshme e remitencave nga punëtorët dhe kreditimi vendor. Rritja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve u përmirësua po ashtu kohëve të fundit, megjithëse nga një bazë e ulët. Përqindja e BPV kushtuar eksportit të mallrave dhe shërbimeve u rrit nga 19.3 përqind në vitin 2015 në 27.1 përqind në vitin 2017, që është shumë afër cakut të SKZH-së prej 28 përqind deri në vitin 2021. Kjo rritje mund t'i atribuohet kryesisht rritjes

<sup>1</sup> Ju lutemi shikoni Tabelën 2 për udhëzimet mbi statusin e progresit për treguesit e SKZH-së.

<sup>2</sup> Formimi i përgjithshëm bruto i kapitalit fiks u rrit nga 25.8 përqind në vitin 2015 në 27.3 përqind në vitin 2017.

së turizmit (d.m.th., të ardhurave nga shërbimet e udhëtimit). Megjithatë, raporti i eksporteve ndaj importeve është përmirësuar vetëm pak, nga 12.3 përqind në vitin 2015 në 13.3 përqind në vitin 2017, me progres të kufizuar drejt cakut prej 18 përqind. Sidoqoftë, kontributi pozitiv i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në rritjen ekonomike ishte dukshëm më i madh në vitin 2016 sesa në vitin 2017 për shkak të rritjes më të madhe të importeve në vitin 2017. Në anën tjetër, IHD-të neto ranë ndjeshëm në vitin 2016, në krahasim me vitin bazë 2015, nga 308 milionë euro në vitin 2015 në 220 milionë euro në vitin 2016. Edhe pse IHD-të neto u rritën në vitin 2017, ato mbetën në nivelin e vitit 2015.

Përkundër këtyre rezultateve të përziera në fushat e rritjes, investimeve dhe tregtisë, ritmi aktual i rritjes duket të jetë duke kontribuar në rezultatet e përmirësuar për treguesit kryesorë të tregut të punës dhe varfërisë.

Nivelet e varfërisë: Varfëria në të ardhura është zvogëluar dukshëm në bazë të të dhënave më të fundit në dispozicion. Një raport mbi varfërinë në konsum të hartuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës gjeti se në vitin 2015, përqindja e popullsisë në Kosovë që jetojnë nën pragun e varfërisë<sup>3</sup> dhe që nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat njerëzore ra nga 30 përqind në vitin 2011 në 17.6 përqind në vitin 2015, edhe pse kjo shkallë mbetet ndjeshëm nën cakun e SKZH-së prej 25 përqind deri në vitin 2021. Ngjashëm, përqindja e popullsisë që jeton nën pragun e varfërisë ekstreme<sup>4</sup> dhe që nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat themelore të mbijetesës ra nga 10 përqind në vitin 2011 në 5.2 përqind në vitin 2015. Po ashtu, hendeku i varfërisë, i cili mat thellësinë e varfërisë dhe merr parasysh përqindjen e popullsisë nën pragun e varfërisë dhe madhësinë e hendekut ndërmjet pragut të varfërisë dhe konsumit mesatar të atyre nën pragun e varfërisë, shënoi rënie. Bazuar në pragun e varfërisë, thellësia e varfërisë shënoi rënie nga 7.8 përqind në vitin 2011 në 3.7 përqind në vitin 2015. Një trend i ngjashëm karakterizon ndryshimet në hendekun e varfërisë së skajshme, i cili ra nga 2.1 përqind në vitin 2011 në 1.1 përqind në vitin 2015.

Tregu i punës: Rezultatet e tregut të punës gjithashtu u përmirësuan në krahasim me bazën gjatë këtyre viteve. Këto përmirësime ishin shumë më të larta në shkallën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore<sup>5</sup> dhe shkallën e punësimit,<sup>6</sup> sesa në shkallën e papunësisë.<sup>7</sup> Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore u rrit nga 37.6 përqind në vitin 2015 në 42.8 përqind në vitin 2017, duke tejkaluar vlerën e synuar të SKZH-së prej 42 përqind deri në vitin 2021. Ngjashëm, shkalla e punësimit u përmirësua nga 25.2 përqind në vitin 2015 në 29.8 përqind në vitin 2017, edhe pse shkalla mbetet nën cakun e SKZH-së prej 34 përqind deri në vitin 2021. Progres i konsiderueshëm është arritur edhe në zvogëlimin e përqindjes së të rinjve jashtë punësimit, arsimit dhe trajnimit, nga 31.3 përqind në vitin 2015 në 27.4 përqind në vitin 2017, duke tejkaluar cakun e SKZH-së prej 25 përqind deri në vitin 2021. Megjithatë, progres shumë i kufizuar është arritur në uljen e shkallës së papunësisë. Në vitin 2017, rreth 30 përqind e fuqisë punëtore u vlerësua të jetë e papunë, nga 32.9 përqind sa ishte në vitin 2015, por ende larg cakut të SKZH-së prej 20 përqind deri në vitin 2021.

<sup>3</sup> Të jetuarit nën kufirin e varfërisë përkufizohet si të jetuarit me 1.82 euro ose më pak për një të rritur në ditë.

<sup>4</sup> Të jetuarit nën kufirin ekstrem (ushqimor) të varfërisë përkufizohet si të jetuarit me 1.30 euro ose më pak në ditë.

<sup>5</sup> Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore është raporti i punësimit dhe papunësisë tek popullsia në moshë pune.


<sup>6</sup> Shkalla e punësimit është raporti i punësimit ndaj popullsisë në moshë pune.

<sup>7</sup> Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve ndaj fuqisë punëtore (njerëzit e punësuar dhe të papunësuar).



E njëjta gjë vlen edhe për shkallët e papunësisë së të rinjve dhe pjesëmarrjen e fuqisë punëtore nga radhët e grave, të cilat, edhe pse u përmirësuan, janë ende larg arritjes së caqeve të SKZH-së.

**FIGURA 1:** Treguesit kyç të tregut të punës për Kosovën



**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës, anketat e fuqisë punëtore për periudhën 2015-2017.

Përkundër përmirësimeve në këta tregues, mbeten shumë pika të cënueshme në tregun e punës. Treguesit kyç si shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkalla e punësimit janë të ulëta sipas standardeve ndërkombëtare, ndërsa shkalla e papunësisë mbetet e lartë. Gjatë periudhës 2015-2017, shkalla e papunësisë ishte 30-33 përqind - dy herë më e lartë sesa shkalla mesatare në rajon dhe katër herë më e lartë sesa mesatarja për vendet e Bashkimit Evropian. Ngjashëm, masat e shfrytëzimit të burimeve të punës, siç është shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkalla e punësimit, janë më të ulëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe dukshëm më të ulëta sesa mesatarja për vendet e Bashkimit Evropian. Treguesit e njëjtë për gratë janë ekstremisht të ulët. Një tjetër faktor shqetësues është kohëzgjatja e papunësisë. Një përqindje e konsiderueshme e të papunëve (71.5 përqind) raportuan se kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj. Për më tepër, edhe pse ka përkufizime dhe vlerësime të ndryshme të përmasave të sektorit joformal në Kosovë,<sup>8</sup> kur aplikohet përkufizimi ligjor i joformalitetit<sup>9</sup> dhe përdoren të dhënat nga Anketa e Fuqisë Punëtore, duket sikur përqindja e atyre të punësuar në mënyrë joformale është rritur nga 15.5 përqind në vitin 2015 në 21.5 përqind në vitin 2017. Për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, përqindja e atyre që kanë punuar pa kontrata ishte 46.2 përqind në vitin 2017.

Këto rezultate tregojnë se zbatimi i masave të SKZH-së duhet të vazhdojë dhe të përshpejtohet për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të mbështetur fitimet në punësim. Rritja e planifikuar në

<sup>8</sup> Shih për shembull, 'Joformaliteti Evropian: Një studim i ekonomisë së fshehur të Kosovës', një studim i Bankës Botërore që ende nuk është publikuar.

<sup>9</sup> Puna joformale përkufizohet si punëtorët me mëditje që nuk kanë një kontratë pune ose punësimi.

investimet publike, duke përfshirë investimin privat në kapacitetet e reja të energjisë, mund të krijojë rritje afatshkurtër në shkallën e rritjes ekonomike. Që kjo rritje të jetë e qëndrueshme në aspektin afatgjatë, masat e SKZH-së në lidhje me konkurrueshmërinë e sektorëve industrialë, të NVM-vë dhe ata bujqësorë dhe në lidhje me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, duhet të forcohen dhe zbatohen plotësisht. Për të mbajtur fitimet në punësim dhe për të arritur përmirësime të mëtejshme, masat e SKZH-së për ngushtimin e hendekut ndërmjet aftësive dhe nevojave të tregut të punës duhet të shtohen dhe të plotësohen përmes rritjes së fushëveprimit, mbulimit dhe financimit të masave aktive të tregut të punës.

**TABELA 1:** Treguesit kyç makroekonomik

	Nr.	Treguesit	Baza (2015)	2016	2017	Vlera e synuar (2021)	Statusi i treguesit
<b>I. Rritja ekonomike</b>	1	BPV për kokë banori (EUR)	3,277	3,386	3,385	5,000	Progres i kufizuar
	1.1	Norma reale vjetore e rritjes së BPV-së	4.1%	4.1%	4.2%	7.0%	Progres i kufizuar
	2	Formimi i bruto kapitalit fiks (% e BPV)	25.8%	25.5%	27.3%	32.0%	Ka progres
<b>II. Tregu i punës</b>	1	Shkalla e punësimit (raporti punësim-popullsi)	25.2%	28.0%	29.8%	34%	Ka progres
	2	Shkalla e papunësisë (totali i të papunëve si % e totalit të fuqisë punëtore)	32.9%	27.5%	30.5%	20%	Progres i kufizuar
	2.1	Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	57.7%	52.4%	52.7%	30%	Progres i kufizuar
	2.2	Përqindja e të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim, totali, NEET (% e popullsisë së të rinjve)	31.4%	30.1%	27.4%	25%	Progres i avancuar
	3	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (% e gjithsej popullsisë 15+ vjeç)	37.6%	38.7%	42.8%	42%	Objektivi i arritur
	3.1	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nga radhët e grave (% e gjithsej popullsisë 15+ vjeç)	18.1%	18.6%	20.0%	27%	Ka progres
<b>III. Kohezioni social</b>	1	% e njerëzve në varfëri	29.9% (2011)	21.1% (2014)	17.6% (2015)	25%	Objektivi i arritur
	2	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor	0.741	N/A		0.80	Nd

IV. Investimet dhe tregtia	1	Hyrjet e përgjithshme të IHD-ve (milion euro, neto)	308.8	220	287.8	600	Nuk ka progres
	1.1	Stoku i IHD-ve si pjesë e BPV-së (%)	56.0%			65%	Nd
	2	Investimet private si përqindje në BPV / vlera nominale / Formimi i bruto kapitalit fiks, sektori privat (% e BPV)	17.9%	17.3%	19.7%		Ka progres
	3	Raporti eksport-import (mallra)	12.3%	11.8%	13.3%	18%	Progres i kufizuar
	4	Përqindja e eksporteve në BPV (mallra dhe shërbime)	19.3%	23.7%	27.1%	28%	Progres i avancuar

**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Produkti Vendor i Qasjeve të Shpenzimeve dhe Prodhimit, TM4 2017, Bruto Produkti Vendor 2008-2016, Anketa e Fuqisë Punëtore (2015-2017), Raporti i Varfërisë në Konsum për Kosovën (2012-2015); Raporti i FMN-në për Kosovën Nr. 1830; Banka Qendrore e Kosovës, të dhënat e Bilancit të Pagesave; të dhënat e Bankës Botërore për Formimin e Bruto Kapitalit Fiks, <<https://data.worldbank.org/indicator/NE.GDI.FTOT.ZS>>.

### 1.3. Rezultatet e matjes fillestare

Udhërrëfyesit e SKZH përfshijnë një grup prej 61 treguesve të dizajnuar për të monitoruar rezultatet (rezultatet përfundimtare) të masave. Vlerat bazë për treguesit janë për vitin 2015 dhe caqet janë caktuar për vitin 2021, viti përfundimtar për zbatimin e SKZH-së. Në kohën e finalizimit të këtij raporti, të dhënat ishin në dispozicion për 38 tregues.

Progres i avancuar drejt caqeve u regjistrua për 11 treguesit në dispozicion (29 përqind). Këto përfshijnë: përfshirjen në arsimin parashkollor (mosha 5-6 vjeç); numrin e ditëve që kërkohet për të hapur një biznes; raportin e rasteve të zgjidhura nga gjykatat ndaj rasteve të reja të parashtrura gjatë vitit; madhësinë mesatare të fermës; kontributin e sektorit të minierave ndaj BPV-së; vëllimin e tregtisë në elektricitet në krahasim me prodhimin vendor; dhe qasjen e ekonomive familjare në infrastrukturën brez-gjerë (broadband).

Janë vërejtur disa përmirësime për 17 tregues shtesë (45 përqind). Nuk kishte përmirësime të regjistruara për 10 tregues (26 përqind), disa nga të cilët madje tregojnë një përkeqësim të situatës, duke përfshirë një përqindje të njerëzve të punësuar që punojnë pa kontratë; vëllimin dhe strukturën e IHD-ve; të hyrat e Kompanisë Trepça; dhe shkallën e kthimit për ndërmarrjet shtetërore. Kërkohet veprim vendimtar për të përmbysur këto trende negative.

Treguesit në dispozicion lejuan vlerësimin e rezultateve për 32 masa. Shumica e këtyre masave (15) regjistruan rezultate paraprake. Katër masa kishin shënuar progres të avancuar drejt caqeve dhe katër të tjera ende nuk kanë regjistruar rezultate.

## 2.


# ZBATIMI DHE REZULTATET E SKZH

## 2.1. Shtylla 1: Kapitali njerëzor


### Zbatimi i përgjithshëm i Shtyllës 1

Shumica e aktiviteteve të udhërrëfyesit të SKZH për zbatimin e Shtyllës 1 janë planifikuar të përfundojnë në vitin 2021. Siç paraqitet në Figurën 2, 63 përqind e të gjitha aktiviteteve të planifikuara tashmë kanë filluar dhe janë ende në procesin e zbatimit. Në përgjithësi, 3 përqind e aktiviteteve të planifikuara tashmë janë zbatuar, 13 përqind tashmë kanë treguar performancë të mirë, dhe 20 përqind nuk kanë filluar ende procesin e zbatimit.

**FIGURA 2:** Shkalla e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara të Shtyllës 1



**FIGURA 3:** Zbatimi i aktiviteteve të Shtyllës 1 sipas masave



Intervenimet e SKZH-së në kuadër të Shtyllës 1 janë përqendruar në zbatimin e masave të mëposhtme:

#### ■ Masa 1: Regjistrimi në arsimin parashkollor dhe parafillor

Shumica e aktiviteteve në kuadër të Masës 1 janë afatgjata dhe planifikohet të përfundojnë në vitin 2021. Progresi i arritur është udhëhequr nga zbatimi i suksesshëm i një numri aktiviteteve:

- Aktiviteti 1.1 - Rritja e numrit të çerdheve publike: Zbatimi ka filluar me ndërtimin e nëntë çerdheve.
- Aktiviteti 1.2 - Rritja e përfshirjes në institucionet private: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 1.3 - Optimizimi i stafit mësimdhënës përmes rialokimit nga nivelet më të larta (arsimi fillor): Zbatimi ka filluar. Gjithsej 660 mësimdhënës janë trajnuar nga 3.750 të synuar.

Janë identifikuar dy tregues që përcjellin progresin e Masës 1: 1.1.1 - përqindja e fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor; dhe 1.1.2 - përqindja e fëmijëve të regjistruar në arsimin parafillor. Të dhënat më të fundit të raportuara treguan progres në lidhje me regjistrimin e shtuar në arsimin parashkollor, nga 30.9 përqind në vitin 2015 në 36 përqind në vitin 2017. Në dy vite të zbatimit të SKZH-së, progres i avancuar është vërejtur në lidhje me regjistrimin e fëmijëve në arsimin parafillor, duke shënuar rritje të regjistrimit të fëmijëve nga 81.3 përqind në vitin 2015 në 92.4 përqind në vitin 2017.

**■ Masa 2: Cilësia e përmirësuar e mësimdhënies në arsimin parauniversitar**

Sipas Masës 2, nga të gjitha (pesë) aktivitetet e planifikuara, 60 përqind kanë filluar zbatimin; 20 përqind kanë treguar performancë të mirë; dhe 20 përqind nuk kanë filluar ende zbatimin (shih Figurën 3). Shumica e aktiviteteve nën këtë masë janë afatgjata dhe planifikohen të përfundojnë në vitin 2021. Në vijim është paraqitur progresi i vëzhguar:

- Aktiviteti 2.1 - Rishikimi dhe përfundimi i procesit të kualifikimit mësimor para hyrjes në shërbim: Zbatimi është planifikuar të fillojë në vitin 2018; pra, të dhënat e zbatimit ende nuk janë në dispozicion.
- Aktiviteti 2.2 - Optimizimi i numrit të mësimdhënësve ekzistues duke pasur kritere të cilësisë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 2.3 - Përsheptimi i procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe të gjitha nën-aktivitetet janë zbatuar në kohë.
- Aktiviteti 2.4 - Zgjerimi i përdorimit të kurrikulave të reja në të gjitha shkollat e mbetura: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 2.5 - Rishikimi i teksteve ekzistuese dhe zhvillimi i teksteve të reja: Zbatimi ka filluar.

Janë përcaktuar dy tregues që përcjellin progresin e Masës 2: 1.2.1 - kualifikimi i mësimdhënësve sipas nivelit të arsimit; dhe 1.2.2 - vlerësimi i testit PISA. Nuk ka të dhëna të raportuara për këta dy tregues. Testi i PISA-s tashmë është zbatuar dhe rezultatet pritet të publikohen në fund të vitit 2018.

**■ Masa 3: Lidhja më e mirë midis arsimit dhe tregut të punës**

Sipas Masës 3, nga të gjitha (pesë) aktivitetet e planifikuara, 60 përqind kanë filluar zbatimin; 20 përqind kanë treguar performancë të mirë; dhe 20 përqind nuk kanë filluar ende zbatimin (shih Figurën 3). Në aspektin praktik, progresi në zbatimin e aktiviteteve është si më poshtë:

- Aktiviteti 3.1 - Përsheptimi i procesit të zhvillimit të standardeve profesionale: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 3.2 - Përcaktimi i fushave me prioritet të lartë në arsimin dhe aftësimin profesional si dhe zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave bërthamë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 3.3 - Zbatimi i pilot sistemit të kombinuar të arsimit dhe aftësimin profesional me elemente të dyfishtë të të nxënësve: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 3.4 - Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar të Nevojave të Aftësive të Parashikimit: Një nën-aktivitet në kuadër të këtij aktiviteti ende nuk ka filluar.
- Aktiviteti 3.5 - Lidhja e aktiviteteve kërkimore në universitete me industrinë nëpërmjet qasjes në specializimet e zgjuara dhe investimet kërkimore dhe zhvillimore: Zbatimi ka filluar.

Janë identifikuar dy tregues që përcjellin progresin e Masës 3: 1.3.1 - numri i profileve që janë përditësuar sipas standardeve profesionale; dhe 1.3.2 - shkalla e papunësisë në mesin e të rinjve

që kanë përfunduar arsimin profesional. Përderisa nuk janë raportuar të dhëna për numrin e profileve të përditësuara sipas standardeve profesionale, progresi i kufizuar është vërejtur në uljen e shkallës së papunësisë tek të rinjtë që kanë përfunduar arsimin profesional, nga 35.9 përqind në vitin 2015 në 33.8 përqind në vitin 2017.

■ Masa 4: Forcimi i funksioneve të ekzaminimit, inspektimit dhe akreditimit në institucionet arsimore

Sipas Masës 4, nga të gjitha (gjashtë) aktivitetet e planifikuara, 66 përqind kanë filluar zbatimin; 17 përqind kanë treguar tashmë një performancë të mirë; dhe 17 përqind nuk kanë filluar ende zbatimin (shih Figurën 3).

- Aktiviteti 4.1 – Ngritja e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Cilësisë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 4.2 - Zbatimi i sistemit të besueshëm të provimit përfundimtar për studentët: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 4.3 - Përmirësimi i provimit përfundimtar për profesionet e rregulluara: Asnjë progres nuk është shënuar për funksionalizimin e Agjencisë për Standarde dhe Vlerësim dhe Këshillit Shtetëror për Profesionistë të Rregulluar.
- Aktiviteti 4.4 - Zgjerimi dhe përmirësimi i sistemit të inspektimeve në sistemin arsimor dhe aspektet e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 4.5 - Përmirësimi i cilësisë së llogaridhënies së institucioneve të akredituara: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 4.6 - Zhvillimi i një sistemi vlerësimi të suksesit të mësimdhënies si dhe një sistemi notimi të mësimdhënësve: Zbatimi ka filluar.

Është identifikuar një tregues për të përcjellë progresin e Masës 4: 1.4.1 - arritja mesatare në testin përfundimtar për klasat 5, 9 dhe testin e maturës. Nuk ka të dhëna në dispozicion për të përcjellë progresin në arritjet e nxënësve të klasës së 5-të. Bazuar në rezultatet më të fundit të testit për nxënësit e klasës së 9-të, nuk është vërejtur progres, duke shënuar rënie në rezultatet e arritjeve nga 64.7 përqind në vitin 2015 në 58.4 përqind në vitin 2017. Progresi i avancuar është vërejtur për nxënësit që hyjnë në testin e maturës, me rritje të rezultateve nga 74 përqind në vitin 2015 në 83.5 përqind në vitin 2017.

■ Masa 5: Optimizimi i shpenzimeve në arsim përmes sistemeve të të dhënave

Sipas Masës 5, nga të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, 50 përqind kanë filluar zbatimin; 25 përqind tashmë kanë treguar performancë të mirë; dhe 25 përqind nuk kanë filluar ende zbatimin (shih Figurën 3).

- Aktiviteti 5.1 - Zhvillimi i një masterplani për rrjetin e shkollave të arsimit dhe aftësisë profesionale: Dy nën-aktivitetet në kuadër të këtij aktiviteti ende nuk kanë filluar.
- Aktiviteti 5.2 - Krijimi i një Sistemi të Menaxhimit të Informacionit në Arsimin e Lartë dhe zhvillimin e sistemeve tjera: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.

- Aktiviteti 5.3 - Rritja e fondeve për arsimin profesional dhe programet e arsimit të lartë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 5.4 - Pilotimi i modelit të partneritetit publiko-privat: Zbatimi ka filluar.

Janë identifikuar dy tregues për të përcjellë progresin e Masës 5: 1.5.1 - përqindja e nxënësve bazuar në profilet e arsimit dhe aftësimin profesional; dhe 1.5.2 - përqindja e studentëve bazuar në profilet e Arsimit të Lartë. Progres i kufizuar është vërejtur në përqindjen e nxënësve bazuar në profilet e arsimit dhe aftësimin profesional, që është rritur nga 43 përqind në vitin 2015 në 52.1 përqind në vitin 2017. Nuk ka të dhëna të raportuara për përqindjen e studentëve bazuar në profilet e Arsimit të Lartë.

#### ■ Masa 6: Rekrutimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës

Sipas masës 6, 67 përqind e të gjitha (pesë) aktiviteteve të planifikuara ende nuk kanë filluar zbatimin dhe 33 përqind e aktiviteteve kanë filluar (shih Figurën 3).

- Aktiviteti 6.1 - Krijimi i një baze të dhënash që përdor regjistrin e diasporës për identifikimin e profileve të ndryshme të diasporës: Zbatimi i një nën-aktiviteti nën këtë aktivitet ende nuk ka filluar dhe planifikohet të fillojë në vitin 2018.
- Aktiviteti 6.2 - Krijimi i Programit për Angazhim në Atdhe: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 6.3 - Zbatimi i programit të Qeverisë Gjermane për kthimin e ekspertëve të diasporës në vitin 2016: Nuk janë raportuar të dhëna.
- Aktiviteti 6.4 - Zbatimi i programit TOKTEN: Nuk janë raportuar të dhëna.
- Aktiviteti 6.5 - Krijimi i një kurrikule online (e-mësimi): Kjo ende nuk është zhvilluar.

Është identifikuar një tregues që përcjell progresin e Masës 6: 1.6.1 - numri i iniciativave (projekteve ose kompanive) të iniciuara nga anëtarë të angazhuar nga diaspora. Deri më tani nuk janë raportuar të dhëna.

#### ■ Masa 7: Adresimi i punësimit joformal dhe krijimi i kushteve adekuate të punës

Sipas Masës 7, 64 përqind e aktiviteteve të planifikuara kanë filluar zbatimin; 13 përqind kanë demonstruar performancë të mirë të zbatimit; dhe 20 përqind nuk kanë filluar ende (shih Figurën 3).

- Aktiviteti 7.1 - Forcimi i dialogut institucional me partnerët social përmes zhvillimit të strukturave dhe kapaciteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 7.2 - Përmirësimi i të drejtave të punonjësve dhe sigurimi i standardeve minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 7.3 - Forcimi i mekanizmave dhe koordinimi i veprimeve institucionale për reduktimin e punësimit joformal: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 7.4 - Krijimi i një sistemi të menaxhimit të informacionit në Inspektoratin e Punës: Aktiviteti është zbatuar.



Janë identifikuar tre tregues që përcjellin progresin e Masës 7: 1.7.1 - numri i lëndimeve dhe lëndimeve fatale në vendin e punës për 10,000 punëtorë; 1.7.2 - përqindja e punonjësve pa kontratë të evidentuar nga inspektimet e Inspektoratit të Punës; dhe 1.7.3 - përqindja e punonjësve pa një kontratë sipas Anketës së Fuqisë Punëtore. Sipas të dhënave të fundit në dispozicion, nuk është vërejtur progres në përqindjen e punëtorëve që punojnë pa kontratë, me një rritje negative nga 15.5 përqind në vitin 2015 në 21.5 përqind në vitin 2017, në krahasim me cakun e SKZH për vitin 2021 prej 12 përqind. Nuk ka të dhëna të raportuara për përqindjen e punëtorëve të punësuar pa kontratë dhe që janë evidentuar nga inspektimet e inspektoratit të punës dhe lëndimet fatale dhe jo-fatale në punë.

## 2.2. Shtylla 2: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit

### Zbatimi i përgjithshëm i Shtyllës 2

Shtylla 2 ka tetë masa. Të dhënat e raportimit tregojnë se 62 përqind e të gjitha aktiviteteve të planifikuara tashmë kanë filluar dhe janë në proces të zbatimit; 8 përqind tashmë janë zbatuar; 23 përqind kanë treguar performancë të mirë; dhe 8 përqind nuk kanë filluar procesin e zbatimit (shih Figurën 4).

**FIGURA 4:** Shkalla e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara të Shtyllës 2





FIGURA 5: Zbatimi i aktiviteteve të Shtyllës 2 sipas masave



Burimi: Metodologjia e monitorimit të SKZH-së bazuar në të dhënat nga ministrinë dhe institucionet tjera.

Ndërhyrjet e SKZH-së në kuadër të Shtyllës 2 janë të përqendruara në zbatimin e masave të mëposhtme:

■ Masa 8: Përmirësimi i mëturjeshëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët

Në kuadër të Masës 8, nga të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, 33 përqind e tyre kanë filluar zbatimin; 33 përqind tashmë tregojnë performancë të mirë; dhe 33 përqind tashmë janë zbatuar (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 8.1 – Krijimi i një regjistri të të gjitha shërbimeve publike: Aktiviteti është zbatuar.
- Aktiviteti 8.2 – Krijimi i një baze qendrore të të dhënave për shërbimet publike: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 8.3 – Vendosja e një sistemi të freskimit të rregullt të informatave lidhur me ofrimin e shërbimeve brenda Ministrisë së Administratës Publike: Nuk është raportuar asnjë informacion për të monitoruar progresin e bërë.
- Aktiviteti 8.4 – Harmonizimi i mëturjeshëm i legjislativës për shërbimet në përputhshmëri me Direktivën e BE-së për shërbimet: Zbatimi ka filluar.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 8: 2.8.1 - numri i shërbimeve të ofruara për qytetarët nga një qendër e shërbimeve; dhe 2.8.2 - koha për të themeluar një biznes. Nuk është shënuar progres në treguesin 2.8.1, me pesë shërbime në vitin 2015 dhe pesë në vitin

2017. Objektivi i treguesit 2.8.2 është arritur, pasi koha e nevojitur për të themeluar një biznes shkurtohet nga 10 ditë sa ishte në vitin 2015, në 5,5 ditë në vitin 2017.

#### ■ Masa 9: Zvogëlimi i pengesave administrative për licenca dhe leje

Në kuadër të Masës 9, nga të gjitha (gjashtë) aktivitetet e planifikuara, 83 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe 17 përqind tregojnë performancë të mirë zbatuese (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 9.1 – Krijimi i një regjistri të të gjitha procedurave të veçanta administrative: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe është në kohë; 232 ligje përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe deri më tani janë analizuar 66 ligje dhe janë dhënë rekomandime.
- Aktiviteti 9.2 – Vendosja e një sistemi për shqyrtimin dhe miratimin e të gjitha procedurave administrative: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 9.3 – Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave administrative: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 9.4 – Adaptimi i qasjes “gjyotinë” për të shkurtuar numrin dhe për të harmonizuar listën e licencave ekzistuese: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 9.5 – Zbatimi i plotë i regjistrimit online të të gjitha lejeve dhe licencave dhe sigurimi se ato që nuk janë të përfshira në regjistër do të jenë të pavlefshme: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 9.6 – Parandalimi i krijimit të kërkesave të pajustificuara për licencim, duke siguruar që ligjet sektoriale të harmonizohen me ligjin e kornizës së përgjithshme: Zbatimi ka filluar.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 9: 2.9.1 - përqindja e procedurave të veçanta administrative që janë në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe 2.9.2 - të paktën 20 përqind e licencave dhe lejeve janë thjeshtuar, bashkuar ose hequr. Të dhënat e fundit të raportuara shfaqin progres në përqindjen e procedurave të veçanta administrative që janë në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga 0 përqind sa ishte në vitin 2015, në 20 përqind në vitin 2017. Megjithatë, më pak progres është vërejtur në treguesin 2.9.2, me një rënie në rezultat, nga 480 sa ishte në vitin 2015, në 410 në vitin 2017.

#### ■ Masa 10: Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të inspektimeve

Në kuadër të Masës 10, 100 përqind e katër aktiviteteve të planifikuara kanë filluar zbatimin (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 10.1 – Miratimi i një ligji të harmonizuar lidhur me inspektimet: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 10.2 – Vlerësimi i të gjitha inspektimeve që bëhen sot, i pasuar me eliminimin e aktiviteteve të panevojshme ose shkrirjen e aktiviteteve inspektuese aty ku ka hapësirë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 10.3 – Krijimi i një mekanizmi koordinues mes trupave inspektues në mënyrë që të sigurohet koordinimi më i mirë i procedurave inspektuese dhe një sistem më efektiv i mbikëqyrjes, duke e përfshirë këtu krijimin e një sistemi informativ për shkëmbimin e informatave ndërmjet inspektorateve: Zbatimi ka filluar.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 10: 2.10.1 - reduktimi i kostos së inspektimeve për bizneset çdo vit; dhe 2.10.2 - numri mesatar i inspektimeve të kryera çdo vit në firmë. Deri më tani nuk janë raportuar të dhëna për këta dy tregues.

#### ■ Masa 11: Miratimi i politikave të bazuara në të dhëna

Në kuadër të Masës 11, nga të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, 67 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe 33 përqind ende nuk kanë filluar zbatimin (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 11.1 – Krijimi i një njësie institucionale për VNR si dhe i njësie brenda ministrive të linjës: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 11.2 – Zbatimi i Strategjisë për Rregullim më të Mirë: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 11.3 – Krijimi i një mekanizmi për mbledhjen dhe ruajtjen sistematike të të dhënave: Zbatimi nuk ka filluar ende.
- Aktiviteti 11.4 – Përdorimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe i komiteteve ad-hoc: Nuk ka progres në lidhje me këtë aktivitet.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 11: 2.11.1 - shkalla në të cilën procesi i zhvillimit të politikave përdor më së miri mjetet analitike; dhe 2.11.2 - shkalla në të cilën përdoret konsultimi publik në zhvillimin e politikave dhe të legjislacionit. Bazuar në të dhënat e raportuara për këta dy tregues, nuk ka pasur progres ende.

#### ■ Masa 12: Mbyllja e hapësirave për abuzime në sistemin e prokurimit publik

Në kuadër të Masës 12, nga të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, 50 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe 50 përqind kanë treguar performancë të mirë (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 12.1 – Zbatimi i ligjit të ndryshuar dhe rregulloreve ekzistuese në fushën e prokurimit publik: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 12.2 – Përsheptimi i zbatimit të platformës elektronike të prokurimit publik: Zbatimi ka filluar.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 12: 2.12.1 - niveli i Shpenzimeve Publike dhe i Llogaridhënies Financiare, treguesi PI-19, konkurrenca, vlera për para dhe kontrollet në prokurim. Ka qenë e vështirë të monitorohet ky tregues pasi vlerësimi i Shpenzimeve Publike dhe i Llogaridhënies Financiare zakonisht bëhet çdo dy vjet dhe për herë të fundit është kryer në vitin 2015. Derisa vlerësimi mund të kryhet me kërkesë të Qeverisë, Ministria e Financave nuk ka kërkuar që vlerësimi të përsëritet që nga koha kur ishte kryer për herë të fundit.

#### ■ Masa 13: Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore

Në kuadër të Masës 13, nga të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, 75% e tyre kanë filluar zbatimin ndërsa 25% nuk kanë filluar zbatimin ende (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 13.1 – Zhvillimi i kornizës ligjore që përcakton qartë të drejtat dhe kushtet ligjore për të drejta të tregtueshme të pronës: Zbatimi ka filluar.

- Aktiviteti 13.2 – Promovimi i tregut të tokës: Zbatimi ka filluar.
- Aktiviteti 13.3 – Fuqizimi i kapaciteteve dhe rolit të gjykatave për njohjen, përcaktimin dhe fuqizimin e të drejtave pronësore: Zbatimi nuk ka filluar ende.
- Aktiviteti 13.4 – Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave përkatëse pronësore të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, si dhe garantimi dhe fuqizimi i të drejtave pronësore për gratë: Zbatimi ka filluar.

Tre tregues janë përcaktuar për të monitoruar progresin e Masës 13: 2.13.1 - kostoja e regjistrimit të pronës (si përqindje e vlerës së pronës); 2.13.2 - vlera totale e pronave të përdorura si kolateral për financim; dhe 2.13.3 - përqindja e pronave të regjistruara në emër të një gruaje. Nuk janë raportuar të dhëna për treguesit 2.13.1 dhe 2.13.2. Progres i avancuar është vërejtur në treguesin 2.13.3, me një rritje nga 15.2 përqind të pronave të regjistruara në emër të gruas sa ishte në vitin 2015, në 20 përqind në vitin 2017.

#### ■ Masa 14: Rritja e efikasitetit të gjyqësorit

Në kuadër të Masës 14, nga të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind e tyre kanë treguar performancë të mirë (shih Figurën 5).

- Aktiviteti 14.1 – Ndryshimi i kornizës ligjore: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 14.2 – Stimulimi i pagesave të hershme të gjobave kundërvajtëse: Aktiviteti është zbatuar.
- Aktiviteti 14.3 – Shkarkimi i sistemit gjyqësor nga rastet e grumbulluara përmes krijimit të një ekipi special prej 100 personash: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 14.4 – Ruajtja e një norme pozitive e pastrimit të rasteve të grumbulluara përmes optimizimit të sistemit të menaxhimit të rasteve dhe Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve përmes përdorimit të Teknologjisë Informative: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.

Janë identifikuar dy tregues për të monitoruar progresin e Masës 14: 2.14.1 - reduktimi i kohës së nevojshme për zgjidhjen e një rasti gjyqësor; dhe 2.14.2 - rastet e zgjidhura në raport me rastet e reja. Të dhënat e fundit të raportuara tregojnë progres të kufizuar sa i përket treguesit 2.14.1, me një reduktim të kohës së nevojshme për zgjidhjen e një rasti gjyqësor nga 414 përqind sa ishte në vitin 2015, në 361 përqind në vitin 2017. Megjithatë, progres i dukshëm është vërejtur dhe objektivi është arritur për treguesin 2.14.2, me një rritje në rezultat, nga 92 përqind sa ishte në vitin 2015, në 141 përqind në vitin 2017.

#### ■ Masa 15: Lufta kundër joformalitetit përmes krijimit të një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave


Masa 15 ka paraparë dy aktivitete që do të mundësojnë krijimin e një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave, megjithatë, Qeveria e Kosovës, në konsultim me partnerët zhvillimorë, ka vendosur ta shqyrtojë këtë prioritet. Një nga opsionet që merren parasysh është bashkimi i disa elementeve operacionale të të dy organizatave pa ndryshuar biznesin e tyre kryesor. Duke pasur parasysh këtë, nuk mund të raportohen të dhëna për zbatimin e kësaj mase.

### 2.3. Shtylla 3: Industritë konkurruese


#### Zbatimi i përgjithshëm i Shtyllës 3

Derisa ekonomia e tregut është më efikase dhe më e aftë për të gjeneruar rritje ekonomike kur ndërhyrja e shtetit në ndërmarrjet private është minimale, shteti gjithashtu ka një rol të pashmangshëm në stimulimin e krijimit të ndërmarrjeve konkurruese në sektorë me vlerë të lartë. Në këtë kontekst, SKZH-ja ka planifikuar një numër aktivitesh të grupuara në kuadër të nëntë masave specifike. Nga këto aktivitete, 10 përqind janë zbatuar plotësisht, 38 përqind janë në rrugën e duhur, 48 përqind kanë filluar zbatimin dhe 3 përqind nuk kanë filluar zbatimin ende (shih Figurën 6).

**FIGURA 6:** Norma e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Shtyllës 3



**FIGURA 7:** Zbatimi i aktiviteteve të Shtyllës 3 sipas masave



**Burimi:** Metodologjia e monitorimit të SKZH-së bazuar në të dhënat nga ministritë dhe institucionet tjera Ndërhyrjet e SKZH-së në kuadër të Shtyllës 3 janë të përqendruara në zbatimin e masave të mëposhtme:

■ Masa 16: Rritja e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare

Investimi i burimeve të Fondit të Privatizimit në asetet strategjike të ekonomisë do të çojë në investimin e fondeve nga asetet e mëparshme të shtetit në asete të reja. Në kuadër të Masës 16, 25 përqind e aktiviteteve të planifikuara janë duke u zbatuar; 50 përqind janë në rrugën e duhur; dhe 25 përqind janë zbatuar plotësisht (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër kësaj mase janë:

- Aktiviteti 16.1 – Operacionalizimi i skemave për garantimin e kredive: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 16.2 – Vlerësimi i operimit të skemës dhe shqyrtimi i mundësive për zgjerim të mëtutjeshëm dhe optimizim të skemës: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 16.3 – Integrimi i bazës së të dhënave të sistemit të regjistrimit të kredive me administratën tatimore: Aktiviteti është zbatuar plotësisht në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 16.4 – Krijimi i lehtësirave speciale për Skemën Vauçer: Zbatimi ka filluar në përputhje me afatin e planifikuar kohor.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 16: 3.16.1 - numri i kredive për NVM-të të mbështetura nga Fondi; dhe 3.16.2 - raporti për kreditë e dhëna nga sektori bankar për sektorin privat, si përqindje e BPV-së. Progres i kufizuar është arritur në numrin e NVM-ve të mbështetura nga Fondi, duke u rritur nga 0 NVM në vitin 2015 në 699 NVM në vitin 2017, por ende larg objektivit prej 4.150 NVM-ve të mbështetura deri në vitin 2021. Progres i kufizuar është vërejtur edhe në kreditë e ofruara nga sektori bankar për sektorin privat, që u rritën nga 22,8 përqind e BPV-së sa ishte në vitin 2015, në 25,1 përqind të BPV-së në vitin 2017, shumë më pak se objektivi prej 40 përqind deri në vitin 2021.

■ Masa 17: Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara

Mbështetja e ndërmarrjeve në rrjetëzimin me grupet përkatëse industriale do të ndihmojë në forcimin e lidhjeve mes industrive, në krijimin e ndërmarrjeve të reja dhe në nxitjen e inovacionit përmes hulumtimeve më të lidhura. Informacioni i këmbyer përmes rrjetëzimit do t'i ndihmojë bizneset të prodhojnë ose të ofrojnë produkte të reja.

Në kuadër të Masës 17, 100 përqind e aktiviteteve të planifikuara po zbatohen dhe po shënojnë progres në përputhje me afatin kohor të planifikuar (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 17.1 – Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare të Konkurrueshmërisë: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 17.2 – Krijimi i një kornize institucionale në mbështetje të zhvillimit të grupi-

meve industriale: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.

- Aktiviteti 17.3 – Krijimi i rrjetit të furnizuesve dhe nën-kontraktorëve: Aktiviteti është zbatuar plotësisht në kohë.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 17: 3.17.1 - niveli i kontributit të industrisë përpunuese në ekonomi (% e kontributit të sektorit industrial në BPV). Është vërejtur progres i dukshëm, me një rritje nga 10,8 përqind sa ishte në vitin 2015, në 11,5 përqind në vitin 2017, dhe kontributi i industrisë së përpunimit në ekonomi parashihet të arrijë në 15 përqind deri në fund të vitit 2021.

#### ■ Masa 18: Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar

Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar do t'ua mundësojë bizneseve të prodhojnë produkte më të sofistikuar dhe më të shtrenjta që janë të përshtatshme për eksport, duke rritur kështu të ardhurat për vete dhe për ekonominë.

Në kuadër të Masës 18, 67 përqind e aktiviteteve të planifikuara janë duke u zbatuar dhe 33 përqind janë në rrugën e duhur në përputhje me afatin e planifikuar kohor (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 18.1 – Krijimi i një instrumenti për të ndihmuar në certifikimin e standardeve të cilësisë për ndërmarrjet kosovare: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 18.2 – Krijimi i një skeme për mbështetjen e inovacionit: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 18.3 – Krijimi i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 18.4 – Krijimi i një fondi për subvencionimin e projekteve të inovacionit në fushën e teknologjisë informative: Raportimi bëhet në kuadër të masës 30.2 të SKZH-së.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 18: 3.18.1 - Treguesi i Vlerës së Shtuar për NVM-të (kundrejt BPV-së); dhe 3.18.2 - Indeksi i Normës së Inovacionit (sipas Global Entrepreneurship Monitor). Sidoqoftë, nuk ka të dhëna për progresin kundrejt këtyre treguesve. Vlera bazë për Treguesin e Vlerës së Shtuar për NVM-të ishte 25,8 përqind në vitin 2015, kundrejt objektivit prej 32 përqind për 2021. Për Indeksën e Normës së Inovacionit, vlera bazë ishte 28,5 përqind në 2015, dhe synimi është që të ketë një trend në rritje deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 19: Promovimi i investimeve të huaja direkte (IHD) dhe rritja e rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik

Rritja e IHD-ve dhe e investimeve nga diaspora do ta ndihmojë ekonominë e Kosovës që t'i përmbushë nevojat e saj financiare, do të sigurojë transferimin e teknologjisë dhe të shkathtësive, dhe do ta zvogëlojë deficitin tregtar. Kështu, bizneset e huaja dhe anëtarët e diasporës do të marrin mbështetje konkrete nga shteti për të investuar në Kosovë.



Në kuadër të Masës 19, 100 përqind e aktiviteteve të planifikuara kanë filluar zbatimin (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 19.1 – Fuqizimi i kapaciteteve të KIESA dhe riorganizimi i saj: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 19.2 – Mbështetja e investimeve të investitorëve strategjik: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 19.4 – Aktivizimi dhe zgjerimi i rrjeteve të bizneseve të diasporës: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 19.5 – Bashkëpunimi në mes të rrjeteve të bizneseve të diasporës si dhe institucioneve të vendit: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

Katër tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin në kuadër të Masës 19: 3.19.1 - Vëllimi i IHD-ve; 3.19.2 - IHD-të e regjistruara në Kosovë; 3.19.3 - numri i investitorëve nga diaspora që zhvillojnë veprimtari ekonomike në Kosovë; dhe 3.19.4 - Struktura e IHD-ve.

Nuk është shënuar progres në treguesin 3.19.1, ku vlera është zvogëluar nga 324,2 milionë euro sa ishte në vitin 2015, në 287,8 milionë euro në vitin 2017, shumë më pak se objektivi prej 850 milionë euro deri në vitin 2021. Progres i madh është vërejtur në treguesin 3.19.2, pasi numri i IHD-ve të regjistruara në Kosovë është rritur nga 307 milionë sa ishte në vitin 2015, në 767 milionë në vitin 2017, duke e arritur dhe tejkaluar synimin prej 460 milionësh deri në vitin 2021. Nuk ka progres në treguesin 3.19.3, pasi numri i investitorëve nga diaspora që zhvillojnë veprimtari ekonomike në Kosovë është zvogëluar nga 100 sa ishte në vitin 2015, në 43 në vitin 2017, shumë më pak se objektivi prej 500 deri në vitin 2021. Nuk ka pasur progres as në treguesin 3.19.4. Për shitjen, blerjen dhe ndërtimin, vlera bazë ishte 76,4 përqind në vitin 2015, dhe 80,6 përqind në vitin 2017; për tregti, financa dhe shërbime, vlera bazë ishte 26,2 përqind në vitin 2015, dhe 24,3 përqind në vitin 2017; për përpunimin industrial, bujqësinë dhe turizmin, vlera bazë ishte 7 përqind në vitin 2015, ndërsa ra në 1,1 përqind në vitin 2017; dhe, për energjinë, transportin dhe minierat, vlera bazë ishte 9,6 përqind në vitin 2015, dhe ra në 3,8 përqind në vitin 2017. Përmes këtyre industrive, qëllimi kryesor është të shihet rritja e përqindjes së IHD-ve në sektorët si industria përpunuese, bujqësia dhe turizmi deri në fund të vitit 2021.

#### ■ Masa 20. Rregullimi i tokave bujqësore

Zgjidhja e çështjes së tokave të fragmentuara bujqësore do të ndihmojë në rritjen e madhësisë mesatare të fermave, të sipërfaqes së parcelave dhe të produktivitetit bujqësor, për shkak të ekonomisë së shkallës. Kjo do të thotë se fermerët do të jenë në gjendje të prodhojnë më shumë dhe se industria e agro-përpunimit do të ketë më shumë lëndë të para vendore.

Në kuadër të Masës 20, 75 përqind e aktiviteteve të planifikuara kanë filluar zbatimin dhe 25 përqind janë në rrugën e duhur (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 20.1 – Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural: Zbatimi ka filluar por me vonesa.
- Aktiviteti 20.2 – Ndërmarrja e reformave strukturore: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

- Aktiviteti 20.3 – Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 20.4 – Formimi i rretit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 20: 3.20.1 - madhësia mesatare e parcelave; dhe 3.20.2 - madhësia mesatare e fermave. Progres i kufizuar është vërejtur në treguesin 3.20.1, pasi madhësia mesatare e parcelave ishte 0,3 hektarë në vitin 2015 dhe ndërmjet 0,3-0,5 hektarë në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 1,0 hektar deri në vitin 2021. Megjithatë, ka progres në treguesin 3.20.2, pasi madhësia mesatare e fermave është rritur nga 1,5 hektarë sa ishte në vitin 2015, në 3,2 hektarë në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 4,0 hektarësh deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 21. Shfrytëzimi i potencialit mineral të Kosovës

Lehtësimi i përdorimit të potencialit mineral të Kosovës, si pjesë e zhvillimit të saj ekonomik, do të nxisë rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese dhe krijimin e ndërmarrjeve të reja që si rezultat do të mundësojnë rritjen ekonomike. Kjo do të thotë se kompanitë do ta kenë më të lehtë kërkimin dhe zhvillimin e projekteve të burimeve minerare.

Në kuadër të Masës 21, 50 përqind e aktiviteteve të planifikuara kanë filluar zbatimin dhe 50 përqind janë në rrugën e duhur (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 21.1 – Krijimi i modaliteteve institucionale për të mbështetur (përmes financimit apo asistencës teknike) projekte të reja strategjike në sektorin mineral: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 21.2 – Mbështetja e programeve kërkimore gjeologjike dhe minerare: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 21.3 – Rregullimi i tregut të kërkimeve dhe zhvillimit të projekteve përmes forcimit të kapaciteteve administrative të organeve mbikëqyrëse dhe agjencive ekzekutive: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 21.4 – Ofrimi i mbështetjes për të zhvilluar infrastrukturën përcjellëse për sektorin mineral, duke përfshirë atë të transportit dhe energjisë: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 21: 3.21.1 - kontributi i sektorit mineral në BPV. Ky tregues ka shënuar progres të theksuar pasi kontributi i sektorit mineral në BPV është rritur nga 2.0 përqind sa ishte në vitin 2015 në 2.3 përqind në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 2.5 përqind deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 22. Ristrukturimi dhe rivitalizimi i Trepçës

Rivitalizimi i plotë i Trepçës pritet të ndihmojë në reduktimin e deficitit tregtar të Kosovës, të gjenerojë të ardhura dhe të ndikojë pozitivisht në shumë industri tjera.

Në kuadër të Masës 22, 25 përqind e aktiviteteve të planifikuara nuk kanë filluar ende zbatimin; 25 përqind kanë filluar zbatimin; 25 përqind janë në rrugën e duhur; dhe 25 përqind janë zbatuar plotësisht (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 22.1 – Analiza finale e fizibilitetit: Aktiviteti është zbatuar plotësisht dhe është në kohë.
- Aktiviteti 22.2 – Hartimi i koncept dokumentit i bazuar në studimin e fizibilitetit: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 22.3 – Rregullimi i çështjeve rreth aseteve dhe bizneseve të paqëndrueshme për rivitalizim: Zbatimi nuk ka filluar ende si dhe ka vonesa.
- Aktiviteti 22.4 – Vendosja për rritjen e afarizmit/prodhimit industrial të mëtejme të Trepçës: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe është në kohë, në përputhje me afatin e planifikuar kohor.

Është identifikuar një tregues për të monitoruar progresin e Masës 22: 3.22.1 - pjesa e rritjes së të ardhurave të gjeneruara nga Trepça. Nuk është arritur fare progres pasi pjesa e rritjes së të ardhurave të gjeneruara nga Trepça është ulur nga 32,5 milionë euro sa ishte në vitin 2015, në 29,5 milionë euro në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 39,0 milionë eurosh deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 23: Zhbllokimi i Fondit të Privatizimit dhe përdorimi i fondit për zhvillim

Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare do të ndihmojë në rritjen e nivelit të kredi-dhënies për ndërmarrjet prodhuese, nivelet e investimeve dhe punësimin, duke zvogëluar në të njëjtën kohë deficitin tregtar. Kjo nënkupton se ndërmarrjet do të jenë në gjendje të marrin kredi me normë më të ulët interesi dhe kërkesa më të ulëta të kolateralit përmes mekanizmit për garantimin e kredisë.

Në kuadër të Masës 23, 100 përqind e aktiviteteve të planifikuara janë duke u zbatuar dhe zbatimi është në përputhje me afatin e planifikuar kohor (shih Figurën 7). Aktiviteti në kuadër të kësaj mase është:

- Aktiviteti 23.2 – Miratimi i ndryshimeve legjislative që do të mundësonin zhbllokimin e fondit dhe krijimin e mekanizmave për shpenzimin e mjeteve: Aktiviteti është zbatuar plotësisht dhe është në kohë.

Sa i përket treguesve, nuk është propozuar ndonjë tregues për të rishikuar performancën e zbatimit të kësaj mase.

#### ■ Masa 24: Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore

Rritja e efektivitetit të ndërmarrjeve shtetërore do t'ua mundësojë këtyre ndërmarrjeve t'i rrisin kontributet e tyre në ekonomi, të rrisin vlerën e tyre dhe t'i rrisin të hyrat për buxhetin e shtetit. Kjo nënkupton që ndërmarrjet shtetërore do të gjenerojnë më shumë fitime dhe se këto fitime do të riinvestohen në shoqëri.

Në kuadër të Masës 24, 50 përqind e aktiviteteve të planifikuara kanë filluar zbatimin dhe 50 përqind janë në rrugën e duhur (shih Figurën 7). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 24.1 – Shqyrtimi i opsioneve për qasje sektoriale në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e korporatave në pronësi publike: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 24.2 – Zhvillimi i proceseve dhe analizave të rrezikut nga ndërmarrjet shtetërore në buxhet dhe në ekonominë e shtetit: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.


Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 24: 3.24.1 - treguesi i Kthimit në Asete. Nuk është shënuar fare progres; përkundrazi, ka pasur regres, nga -0,18 pikë sa ishte në vitin 2015 në -4,8 pikë në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 2,50 pikëve deri në vitin 2021.

## 2.4. Shtylla 4: Infrastruktura


### Zbatimi i përgjithshëm i Shtyllës 4

Aktivitetet ekonomike nuk mund të zhvillohen pa një mjedis dhe infrastrukturë të përshtatshme. Zhvillimi i infrastrukturës duhet të kryhet brenda një ambienti dhe ekosistemi të qëndrueshëm, pasi natyra është infrastruktura kryesore e jetës. Në kuadër të Shtyllës 4, 5 përqind e aktiviteteve të planifikuara janë zbatuar plotësisht; 24 përqind janë në rrugën e duhur; 57 përqind kanë filluar zbatimin; dhe 14 përqind nuk kanë filluar zbatimin ende (shih Figurën 8).

**FIGURA 8:** Norma e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të Shtyllës 4



**Figura 9:** Zbatimi i aktiviteteve të Shtyllës 4 sipas masave



**Burimi:** Metodologjia e monitorimit të SKZH-së bazuar në të dhënat nga ministritë dhe institucionet e tjera.

Ndërhyrjet e SKZH-së në kuadër të Shtyllës 4 janë të përqendruara në zbatimin e masave të mëposhtme:

■ Masa 25. Ndërtimi i kapaciteteve të reja dhe të qëndrueshme energjetike

Rritja e kapaciteteve lokale për prodhimin e energjisë nga linjiti dhe nga burimet e ripërtërishme të energjisë do ta mundësojë një furnizim më të besueshëm me energji elektrike për qytetarët dhe bizneset, duke krijuar një klimë të përshtatshme për investime dhe duke zvogëluar deficitin tregtar. Përveç kësaj, furnizimi me energji elektrike nuk do të jetë më shqetësim për bizneset e interesuara që të investojnë në Kosovë.

Në kuadër të Masës 25, nga të gjitha (pesë) aktivitetet e planifikuara, 60 përqind e tyre kanë filluar zbatimin; 20 përqind janë në rrugën e duhur; dhe 20 përqind nuk kanë filluar zbatimin ende (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 25.1 – Zgjatja e procesit të dekomisionimit të TC Kosova A: Zbatimi nuk ka filluar ende si dhe ka vonesa.
- Aktiviteti 25.2 – Rehabilitimi i TC Kosova B: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 25.3 – Ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re: Zbatimi ka filluar në përputhje me afatin kohor të planifikuar (është mbyllur faza e parë e projektit “Mbyllja komerciale”).

- Aktiviteti 25.4 – Zbatimi i reformave strukturore në KEK: Zbatimi ka filluar por me vonesa.
- Aktiviteti 25.5 – Hapja e minierës së re të thëngjillit (Sibofci Jugor): Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 25: 4.25.1 - reduktimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike; dhe 4.25.2 - prodhimi i energjisë elektrike. Të dy objektivat e treguesit janë përmbushur, madje edhe janë tejkaluar. Sa i përket ndërprerjeve të energjisë elektrike, numri i orëve në vit ka rënë nga 384 sa ishte në vitin 2015, në 100.98 në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 192 orëve në vit. Për prodhimin e energjisë elektrike, numri i kilovatëve në orë në vit u rrit nga 3.550 sa ishte në vitin 2015, në 5.300 në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 4.000 deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 26. Krijimi i një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike

Ndërtimi i një linje transmisioni për t'i diversifikuar burimet e importit të energjisë elektrike do të mundësojë një furnizim më të besueshëm dhe më të përballueshëm me energji elektrike, sidomos gjatë kohës së pikut. Kjo do të thotë që Kosova nuk do të importojë energji elektrike të shtrenjtë, gjë që do t'i ulë kostot e energjisë elektrike për qytetarët dhe bizneset.

Në kuadër të Masës 26, nga të gjitha (dy) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind kanë filluar zbatimin dhe progresi ka qenë i mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 26.1 – Integrimi i tregut të energjisë me tregun rajonal të energjisë: Zbatimi ka filluar në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 26.2 – Funkcionalizimi i linjës së transmisionit prej 400 KV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës: Zbatimi është realizuar në përputhje me afatin e planifikuar kohor.

Një objektiv është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 26: 4.26.1 - raporti mesatar i energjisë elektrike të tregtuar ndaj prodhimit vendas. Objektivi për këtë tregues është përmbushur pasi raporti është rritur nga 21,3 përqind sa ishte në vitin 2015, në 23,7 përqind në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 23,5 përqind deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 27. Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të eficientës

Në kuadër të Masës 27, nga të gjitha (tri) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe progresi ka qenë i mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 27.1 – Krijimi i Fondit për Eficientë të Energjisë: Zbatimi ka filluar në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 27.2 – Fillimi i zbatimit të praktikës së kontratave të performancës për kursim të energjisë: Zbatimi ka filluar por me vonesa.
- Aktiviteti 27.3 – Zgjerimi i rrjetit të ngrohtores: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 27: 4.27.1 - rritja e kursimeve të energjisë. Nuk ka të dhëna për këtë tregues, i cili ka një vlerë bazë prej 4 përqind në vitin 2015

dhe një objektiv prej 9 përqind deri në vitin 2021. Derisa ka pasur progres të kufizuar, numri i përdoruesve të kyçur në rrjetin e ngrohtores ishte 14.886 në vitin 2015, dhe u rrit në 1.850 në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 20.000 përdoruesve deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 28. Shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtërishme të energjisë

Investimet në masat e efikasitetit të energjisë do të ulin konsumin e brendshëm të energjisë dhe rrjedhimisht edhe shpenzimet e përgjithshme financiare, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe zvogëlimin e ndikimeve mjedisore. Bizneset do të paguajnë më pak energji për shkak të investimeve në izolimin në mjediset industriale.

Në kuadër të Masës 28, nga të gjitha (dy) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe progresi është i mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 28.1 – Rishikimi dhe negocimi i caqeve më të ulëta për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 28.3 – Mundësimi i kontratave afatgjata për fermerë që të shfrytëzohen mbetjet organike si dhe sigurimi i organizimit më të mirë i tregut të drurit dhe mbetjeve mallore: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në përputhje me afatin e planifikuar kohor.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 28: 4.28.1 - përqindja e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme. Nuk ka të dhëna për këtë tregues, i cili ka një vlerë bazë prej 19,8 përqind në vitin 2015 dhe një objektiv prej 25,0 përqind deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 29. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore

Kompletimi i akseve rrugore kryesore ndërkombëtare dhe rajonale dhe i hekurudhave ndërkombëtare do të mundësojë lëvizje më të shpejtë të njerëzve dhe mallrave dhe ulje të kostove për bizneset. Kjo do t'ua mundësojë bizneseve që të dërgojnë mallra më të lehtë në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të Masës 29, nga të gjitha (shtatë) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe progresi është i mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 29.1 – Finalizimi i segmenteve të mbetura të Autostradës Morinë – Merdar (R7): Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 29.2 – Përfundimi i ndërtimit të Autostradës Prishtinë – Han i Elezit (R6) për t'u lidhur me Korridorin e VIII të Evropës Juglindore: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 29.3 – Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale Prishtinë – Pejë (M9) dhe Prishtinë – Mitrovicë (M2): Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 29.4 – Zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë - Podujevë: Përgatitja e zbatimit të projektit dhe dokumentacioni për ofertimin dhe ekzekutimin e punëve është në një fazë

të avancuar dhe në kohë.

- Aktiviteti 29.5 – Zgjerimi i rrugëve nacionale Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren: Zbatimi ka filluar dhe është në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 29.6 – Ndërtimi i autostradës Prishtinë – Gjiilan – Dheu i Bardhë: Zbatimi ka filluar dhe është në përputhje me afatin e planifikuar kohor.
- Aktiviteti 29.7 – Modernizimi i linjës së vetme ndërkombëtare hekurudhore në Kosovë, Linja 10: Zbatimi ka filluar dhe është në përputhje me afatin e planifikuar kohor.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 29: 4.29.1 - zvogëlimi i kohës mesatare të udhëtimit në transportin rrugor; vëllimi i transportit hekurudhor të udhëtarëve; dhe vëllimi i transportit hekurudhor të mallrave. Nuk ka të dhëna për këtë tregues, i cili ka një vlerë bazë prej 120 minutash në vitin 2015; 0,183 milion udhëtarë në vit në vitin 2015; dhe 0,154 milion ton neto mallrash në vit në vitin 2015.

#### ■ Masa 30. Shtrirja e infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikuese

Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operacionet e biznesit, në shkolla dhe në institucione publike do t'i ulë kostot operacionale dhe do t'i lehtësojë investimet dhe inovacionin në rritje. Përdorimi i teknologjisë së informacionit do t'i ndihmojë bizneset të kursejë dhe t'i përdorin këto kursime për të investuar në linja të reja biznesi.

Në kuadër të Masës 30, nga të gjitha (tri) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe progresi është i mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:

- Aktiviteti 30.1 – Krijimi i Këshillit Nacional për TI: Aktiviteti është zbatuar plotësisht dhe është në kohë.
- Aktiviteti 30.3 – Miratimi i standardeve ndërkombëtare përkatëse të TIK-ut: Zbatimi ka filluar por me vonesa.
- Aktiviteti 30.4 – Zbatimi i Programit për Ekonominë Digjitale të Kosovës: Zbatimi ka filluar dhe është në përputhje me afatin e planifikuar kohor.

Një tregues është identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 30: 4.30.1 - zgjerimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Progres i avancuar është vërejtur për këtë tregues pasi infrastruktura e teknologjisë së informacionit është zgjeruar, me mbulimin e popullsisë që është rritur nga 75 përqind sa ishte në vitin 2015, në 92,5 përqind në vitin 2017, duke iu afruar kështu objektivit prej 100 përqind deri në vitin 2021.

#### ■ Masa 31. Infrastruktura bujqësore në funksion të agro-biznesit

Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimin bujqësor do të ndihmojë në uljen e kostos së produkteve bujqësore, në rritjen e produktivitetit dhe të ardhurave të fermave dhe në lehtësimin e operacioneve të industrisë së agro-përpunimit.

Në kuadër të Masës 31, nga të gjitha (tri) aktivitetet e planifikuara, 100 përqind e tyre kanë filluar zbatimin dhe progresi është i mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet në kuadër të kësaj mase janë:



- Aktiviteti 31.1 – Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 31.2 – Rritja e numrit të objekteve të magazinimit: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 31.3 – Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 31.4 – Rritja dhe përmirësimi i strukturave të fermave, si dhe rritja e kapaciteteve përpunuese të industrisë ushqimore: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.
- Aktiviteti 31.5 – Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të informatave: Zbatimi është në një fazë të avancuar dhe në kohë.

Dy tregues janë identifikuar për të monitoruar progresin e Masës 31: 4.31.1 - rritja e vlerës së shtuar bruto në prodhimin bujqësor; dhe 4.31.2 - sipërfaqja e tokës së punueshme me sistemin e ujitjes në të gjithë sipërfaqen e Kosovës. Nuk ka të dhëna për këta tregues. Në treguesin e parë, rritja e vlerës së shtuar bruto në prodhimin bujqësor ishte 10,5 përqind në vitin 2015, në vitin 2016 është 17 përqind<sup>10</sup> dhe objektivi është 60 përqind deri në vitin 2021; ndërsa për treguesin e sipërfaqes së tokës së punueshme me sistemin e ujitjes ishte 21 përqind në vitin 2015 dhe objektivi është 40 përqind deri në vitin 2021, nuk ka të dhëna.

#### ■ Masa 32. Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapaciteteve të burimeve ujore

Racionalizimi i shfrytëzimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse sigurojnë që rritja e industrive të Kosovës dhe e kërkesës për ujë të shkojë paralelisht me rritjen e burimeve ujore në dispozicion. Do të thotë se bizneset dhe qytetarët do të kenë furnizim të rregullt me ujë.

Sipas masës 31, të gjitha (gjashtë) aktivitetet e planifikuara, kanë filluar 100% zbatimin dhe deri më tani kanë shënuar progres të mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet sipas kësaj mase janë:

- Aktiviteti 32.1 – Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 32.2 – Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjeteve të reja: Zbatimi nuk ka filluar ende.
- Aktiviteti 32.4 – Dizajnimi i projektit për ndërtimin e sistemit ujqor “Ibër-Lepenc”: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 32.5 – Investimi në zgjerim dhe rritje të efijencës së sistemeve të ujitjes: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 32.6 – Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumenjve: Nuk ka të dhëna në dispozicion për progresin e këtij aktiviteti.
- Aktiviteti 32.7 – Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm: Zbatimi ka filluar, por me vonesa.

Për përcjelljen e progresit të Masës 32 janë identifikuar dy tregues: 4.32.1 - zvogëlimi i nivelit të humbjeve; dhe 4.32.2 - shkalla e lidhjeve në rrjet. Gjithashtu është arritur progres i kufizuar sa i përket këtyre treguesve. Baza për treguesin 4.32.1 ishte 60% në vitin 2015, dhe u zvogëlua në 56% në vitin 2017, kurse synimi është të arrihet 30% në vitin 2021. Shkalla e lidhjeve në rrjet ishte 76% në vitin 2015, krahasuar me 79% në vitin 2017, kurse synimi është të arrihet 84% në vitin 2021.

#### ■ Masa 33. Shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve

Sigurimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës do të bëjë që pyjet e Kosovës të mos degradohen dhe të mos shkaktohen pasoja në ekosistem dhe gjithashtu lehtëson që industria në Kosovë të ketë furnizim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të drunjtve.

Sipas Masës 33, të gjitha (3) aktivitetet e planifikuara, kanë filluar 100% zbatimin dhe deri më tani kanë shënuar progres të mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet sipas kësaj mase janë:

- Aktiviteti 33.1 – Pyllëzimit i sipërfaqeve të zhveshura pyjore, rimëkëmbja e pyjeve të dëmtuara nga zjarri: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 33.2 – Ndërmarrja e masave më të ashpra kundër prerësve ilegal: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.
- Aktiviteti 33.3 – Zhvillimi i planeve për menaxhimin e pyjeve: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

Për përcjelljen e progresit të Masës 33 janë identifikuar dy tregues: 4.33.1 - shkalla e rigjenerimit të pyjeve; dhe 4.33.2 - zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të sipërfaqeve pyjore publike. Nuk ka të dhëna për këto tregues. Sa i përket shkallës së rigjenerimit të pyjeve, baza ishte 30% në vitin 2015 kurse synimi është të arrihet 60% në vitin 2021. Shfrytëzimi ilegal i sipërfaqes publike pyjore ishte 30% në vitin 2015, kurse synimi është të arrihet 17.5% në vitin 2021.

#### ■ Masa 34. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave

Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave parandalon ndikimet negative mjedisore të konsumit dhe rivendosë praktikën e qëndrueshme për prodhim industrial, duke gjeneruar ndërkohë punësim dhe ulje të kostove për industrinë prodhuese.

Në kuadër të Masës 34, të gjitha (katër) aktivitetet e planifikuara, kanë filluar 100% me zbatim dhe deri më tani kanë shënuar progres të mirë (shih Figurën 9). Aktivitetet sipas kësaj mase janë:

- Aktiviteti 34.1 – Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave komunale, të ngurta, të ndërtimit, industriale dhe të rrezikshme dhe të lymit nga ujërat e ndotura: Zbatimi nuk ka filluar ende.
- Aktiviteti 34.5 – Riparimi dhe ndërtimi i rrjeteve grumbulluese për ujërat e ndotura (zeza) si dhe ndërtimi i fabrikave për trajtimin e ujërave të ndotura në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë: Zbatimi ka filluar dhe është në kohë.

- Aktiviteti 34.6 – Ndërtimi i stacionit bartës dhe qendrës për mbledhjen e mbeturinave (Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë): Zbatimi nuk ka filluar ende.
- Aktiviteti 34.7 – Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operuese në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash-Obiliq: Zbatimi nuk ka filluar ende.

Për përcjelljen e progresit të Masës 34 janë identifikuar dy tregues: 4.34.1 - shkalla e përqindjes së grumbullit të mbeturinave; dhe 4.34.2 niveli i riciklimit të mbeturinave. Shkalla e përqindjes së grumbullit të mbeturinave ka arritur progres të kufizuar, që ishte 60% në vitin 2015 dhe 62% në vitin 2016, kurse synimi është të arrihet 90% në vitin 2021. Ndërsa, niveli i riciklimit të mbeturinave nuk ka shënuar progres, që ishte 25% në vitin 2016 dhe përsëri 25% në vitin 2017, kurse synimi është të arrihet 40% në vitin 2021.

# 3.

## PLANIFIKIMI FINANCIAR DHE RAPORTIMI

### 3.1. Procesi i kostimit të masave të SKZH-së

Procesi i kostimit të SKZH-së ka përdorur një qasje nga poshtë-lartë, duke filluar me kostimin e rezultateve/nën-aktiviteteve, aktiviteteve dhe masave, dhe më pas duke kaluar tek kostimi i shtyllave dhe tek zbatimi i përgjithshëm i SKZH-së. Bazë fillestare e llogaritjes së kostos ka qenë, rrjedhimisht, kostimi i nën-aktiviteteve të nevojshme për kryerjen e një aktiviteti të planifikuar, ndërsa ndikimi i përgjithshëm financiar i SKZH-së u llogarit si shuma totale që përmban elemente të ndryshme të udhërrëfyesit të SKZH-së.

Me qëllim të lehtësimit të procesit të kostimit, Zyra për Planifikim Strategjik ka zhvilluar një model dhe udhëzues të kostimit të bazuar në tabela. Gjithashtu, ZPS-ja ka mbështetur ministritë e linjës me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë së kostos. Modeli i kostos përfshinë një grup çmimesh referuese për kostot e artikujve tipikë.

Po ai model kostimi i bazuar në tabela u përdor për të mbledhur informata mbi financimet e pritshme. Ministritë e linjës kanë ofruar informata sa i përket fondeve në buxhet që janë tashmë në dispozicion, të cilat janë ndarë nga Ministria e Financave përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Ministritë e linjës gjithashtu ofruan informata mbi ndihmën financiare të jashtme që ishte tashmë në dispozicion, si dhe mbi masat dhe kreditë që tashmë ishin miratuar ose në procesin e pajtimit. Disa ministri të linjës gjithashtu vënë në dukje pritjet e tyre sa i përket financimit privat përmes partneriteteve publiko-private. Dallimi ndërmjet kostos totale të vlerësuar të masës dhe financimit në dispozicion paraqet boshllëkun aktual të financimit. Një boshllëk më i madh financimi, kryesisht lidhur me projektet e infrastrukturës, u identifikua për Shtyllën 4.

Kostoja totale e zbatimit të secilës masë është zberthyer më tej sipas viteve të zbatimit të SKZH-së (d.m.th, 2017-2021). Udhërrëfyesi i SKZH-së ofron informata mbi kostot vjetore të vlerësuar të masave, kostot totale të aktiviteteve dhe nën-aktiviteteve, si dhe burimet e pritura të financimit.

### 3.2. Raportimi mbi shpenzimet e zbatimit të masave të SKZH-së

Procesi i raportimit të zbatimit të SKZH-së bazohet në udhërrëfyesin e SKZH-së, i cili përcakton afatet kohore për zbatimin e masave dhe kostove dhe burimeve të financimit të masave, dhe përcakton treguesit e duhur për monitorimin e zbatimit të masave dhe rezultateve. Si pjesë e këtij

procesi, ministritë e linjës përdorën një tabelë të veçantë për të raportuar shpenzimet e bëra gjatë zbatimit të masave të SKZH-së në vitin 2017.

Raportimi mbi kostot e zbatimit të aktiviteteve të SKZH-së ka qenë më i kufizuar sesa raportimi mbi progresin e aktivitetit. Ka pasur mungesë të raportimit mbi kostot e shkaktuara deri më sot, si dhe mbi shpenzimet e mbetura të zbatimit për masën gjatë viteve të ardhshme. Kryesisht është identifikuar raportim i saktë brenda kufijve të planifikuar, për zbatimin e masave lidhur me realizimin e projekteve kapitale. Sfidat kyçe të identifikuara në raportimin e kostove të zbatimit të SKZH-së, mund të kategorizohen si më poshtë:

- 1.** Për një numër masash, raportimi mbi kostot e zbatimit të masave është i kufizuar dhe nuk ka mekanizma për verifikimin e saktësisë së raportimit të kostos.
- 2.** Një numër i konsiderueshëm i masave nuk kanë raportim të kostos. Në raste të tilla, ministritë e linjës nuk kanë dhënë informata në lidhje me kostot e zbatimit, pavarësisht se kanë raportuar për progresin e arritur në zbatimin e nën-aktiviteteve.
- 3.** Në një grup tjetër masash, ministritë e linjës raportuan vlerat e buxhetuara si kosto për masat. Kjo tregon raportime të pasakta dhe jo të besueshme.
- 4.** Në shumicën e masave që përfshijnë financimet nga ana e donatorëve, mungojë raportimet për shpenzimet e financimeve të tyre.

Bazuar në sfidat e raportimit të kostos, janë identifikuar dy çështje kryesore si problematike në raportimin cilësor:

- 1.** Çështja e parë ka të bëjë me mungesën e përvojës së ministrisë së linjës me kostot e raportimit lidhur me programet/aktivitetet specifike të SKZH-së në përputhje me kërkesat e metodologjisë së raportimit.
- 2.** Çështja e dytë lidhet me strukturën aktuale buxhetore të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe me tabelat vjetore të buxhetit. Planifikimi dhe prezantimi aktual në tabelat e buxhetit e bëjnë të pamundur identifikimin e kostove që lidhen drejtpërsëdrejti me politika/aktivitete të caktuara.

Siç u vë në pah, problemet e identifikuara në raportimin e kostove të zbatimit të SKZH-së përjashtojnë vlerësimin korrekt të kostove aktuale të bëra në zbatimin e SKZH-së dhe identifikimin e kostove të mbetura për vitet e ardhshme. Prandaj, një numër i rekomandimeve do të sigurohen sipas nenit 5 të këtij raporti, në mënyrë që procesi i raportimit të kostos të përmirësohet edhe më shumë.

# 4.

## HARMONIZIMI I OZHQ-së ME SKZH-në

### 4.1. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm: Aplikimi global dhe ndërkombëtar

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm u miratua në vitin 2015 nga të gjitha Shtetet Anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Marrëveshja shënoi një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimit global dhe është bërë pika kryesore e referimit në lidhje me përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë për synim zgjidhjen e sfidave globale.<sup>11</sup> Agjenda globale udhëhiqet nga 17 OZHQ, të cilat e krijojnë vizionin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes një kombinimi të objektivave socialë, ekonomikë dhe mjedisorë. Megjithatë 17 OZHQ paraqesin objektivat e përgjithshme, 169 synime u përcaktuan për udhëheqjen e zbatimit të agjendës drejt objektivave themelore, për t'i dhënë fund të gjitha formave të varfërisë, duke adresuar sfidat mjedisore dhe duke mos lënë asgjë anash.

Vendet po e përkthejnë këtë vizion dhe projekt të përbashkët për prosperitetin e njerëzve dhe planetit në planet dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit, me qëllim të lehtësimit të përfshirjes së plotë kombëtare, zbatimit dhe arritjes së SKZH-ve. Procesi i përfshirjes së plotë kombëtare të SKZH-ve përfshinë integrimin e synimeve të OZHQ-së në kornizën strategjike kombëtare, buxhetimin e qëndrueshëm, si dhe krijimin e sistemeve të raportimit dhe vlerësimit për të monitoruar progresin drejt synimeve të rena dakord në nivel global.<sup>12</sup>

Në përputhje me këto përpjekje, Kuvendi i Kosovës konfirmoi zotimin e institucioneve të Kosovës për të avancuar Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm me miratimin unanimit të Rezolutës së OZHQ në janar të vitit 2018.<sup>13</sup> Për të siguruar një pronësi më të fortë politike, u themelua Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm - një Grup Parlamentar - për të udhëhequr integrimin dhe monitorimin e mëtejshëm të zbatimit të OZHQ-ve. Përderisa miratimi i Rezolutës së OZHQ-së pasqyron angazhimin e përgjithshëm të Parlamentit me agjendën e vitit 2030, harmonizimi i SKZH-së me OZHQ-të paraqet integrimin aktual të OZHQ-ve në agjendën kombëtare dhe sinjalizon angazhimin kombëtar për arritjen e OZHQ-ve. Si pjesë e zhvillimit të Udhërrëfyesit të zbatimit të SKZH-ve, masat e SKZH-së u harmonizuan me OZHQ-të për të siguruar që kontributi i përgjithshëm i SKZH-së për OZHQ-të të jetë i vlerësuar. Harmonizimi i SKZH-së me OZHQ-të ka krijuar hapësirë për procesin e nacionalizimit të OZHQ-së dhe gjithashtu mundëson monitorim dhe raportim efektiv të progresit të arritur ndaj një numri synimesh të OZHQ-ve.

<sup>11</sup> Platforma e Njohurive për Zhvillim të Qëndrueshëm, "Transformimi i botës sonë: Agjenda e 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm", Organizata e Kombeve të Bashkuara, <<https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>>, qasur më 3 tetor 2018.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, <[www.kuvendikosoves.org/common/docs/2018\\_01\\_30\\_Resolution\\_06\\_R\\_001.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2018_01_30_Resolution_06_R_001.pdf)>, qasur më 3 tetor 2018.



Ky kapitull shqyrton progresin e bërë në të gjitha masat e SKZH-së drejt synimeve të harmonizuara. Në të përshkruhet mbulimi i OZHQ-ve brenda SKZH-ve, progresi brenda dy viteve të para të zbatimit të SKZH dhe OZHQ-të që nuk adresohen nga SKZH-ja.

## 4.2. Harmonizimi i synimeve të OZHQ me SKZH

Megjithëse SKZH-ja u miratua para përkufizimit përfundimtar të OZHQ-ve dhe synon të arrijë masat e tij deri në vitin 2021, ajo përfshinë elemente që kontribuojnë drejtpërsëdrejti në arritjen e synimeve të OZHQ-së gjatë zbatimit të SKZH-së. Edhe pse SKZH-ja nuk mbulon të gjitha aspektet e OZHQ-ve, mbulimi i saj relativisht i mirë ndaj OZHQ-ve dhe synimeve të saj përcaktojnë një precedent premtues për hartimin e planifikimit të ardhshëm strategjik nga fokusi i OZHQ-së në vitet e ardhshme.

Nga të gjitha 17 OZHQ dhe 169 synime të OZHQ-së, u konstatuan se 12 objektiva dhe 22 synime janë në përputhje me SKZH-në. 12 objektiva ishin në përputhje me 27 tregues të SKZH-së. Nga 22 synime, 18 ishin në përputhje me masat e paracaktuara të SKZH-së dhe katër ishin në përputhje me treguesit e nivelit makroekonomik të SKZH-së. Tabela 2 tregon se si objektivat dhe synimet e OZHQ-së harmonizohen me masat e SKZH-së.

**TABELA 1.** Harmonizimi i objektivave dhe synimeve të Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm me masat e SKZH-së

OZHQ-të	Synimet e OZHQ-së	Masat e SKZH-së
<p><b>2</b> ZERO URI</p> 	<p>2.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve ushqimorë në shkallë të vogël, veçanërisht të grave, popujve indigjenë, familjeve fermere, blegtorëve dhe peshkatarëve, përfshirë edhe përmes qasjes së sigurt dhe të barabartë në toka, burime tjera prodhuese, njohuri, shërbime financiare, tregje dhe mundësi për shtimin e vlerës dhe punësimin jashtë sektorit bujqësor.</p>	<p>31. Infrastruktura bujqësore në shërbim të agrobiznesit</p>
<p><b>4</b> ARSIM CILËSOR</p> 	<p>4.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjitha vajzat dhe djemtë kanë të drejtë për zhvillim cilësor që në fëmijërinë e hershme, për përkujdesje dhe për edukim para-shkollor, në mënyrë që të jenë gati për arsimim fillor.</p>	<p>1. Regjistrimi në arsimin parashkollor dhe parafillor</p>
	<p>4.C Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm numri i mësimit të kualifikuar, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar për trajnimin e mësimit të kualifikuar në vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim.</p>	<p>2. Cilësia e avancuar e mësimit të kualifikuar në arsimin parauniversitar</p>
	<p>4.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë të përfundojnë shkollimin fillor dhe të mesëm pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, që çon në rezultate të rëndësishme dhe efikase të të mësuarit.</p>	<p>2. Cilësia e avancuar e mësimit të kualifikuar në arsimin parauniversitar</p>



<p><b>5</b> BARAZI GJINORE</p> 	<p>5. Të ndërmerren reforma për t'i dhënë grave të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike dhe të drejta pronësie dhe kontrolli mbi tokën dhe forma të tjera të pronësisë, të shërbimeve financiare, të trashëgimisë dhe burimeve natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare.</p>	<p>13. Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore</p>
<p><b>6</b> UJË I PASTËR DHE KANALIZIME</p> 	<p>6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë.</p>	<p>32. Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapaciteteve të burimeve ujore</p>
<p><b>7</b> ENERGJIE PËRBALLUESHME DHE E PASTËR</p> 	<p>7.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e përgjithshme në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë.</p>	<p>25. Ndërtimi i kapaciteteve të reja dhe të qëndrueshme të gjenerimit të energjisë</p>
<p><b>8</b> PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE</p> 	<p>8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denja për të gjitha gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagesa të barabartë për punën me vlerë të njëjtë.</p>	<p>3. Lidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës</p>
	<p>8.3 Të përkrahen politika të orientuara në zhvillim, që mbështetin aktivitetet prodhuese, krijimin e vendeve të denja të punës, sipërmarrjen, krijimtarinë dhe risitë dhe të nxitet formalizimi dhe rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë edhe qasjen tek shërbimet financiare.</p>	<p>7. Trajtimi i punësimit joformal dhe krijimi i kushteve adekuate të punës</p>
	<p>8.8 Të mbrohen të drejtat për punë dhe të mundësohen mjedise të sigurta pune për të gjithë punëtorët, përfshirë punëtorët emigrantë, e në veçanti gratë emigrante dhe ata që punojnë në punë jo të sigurta.</p>	<p>7. Trajtimi i punësimit joformal dhe krijimi i kushteve adekuate të punës</p>



<p><b>9</b> INDUSTRI, NOVACION DHE INFRASTRUKTURË</p> 	<p>9.3 Të rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla industriale dhe e ndërmarrjeve të tjera, në veçanti në vendet në zhvillim, tek shërbimet financiare, duke përfshirë kredi të përballueshme dhe integrimi i tyre në zinxhirët e vlerave dhe të tregjeve.</p>	<p>16. Rritja e qasjes në financa për NVM-të e Kosovës</p> <p>17. Rrjeti dhe zhvillimi i grupeve të NVM-ve</p>
	<p>9.2 Të promovohet industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe deri në vitin 2030, të rritet në mënyrë të konsiderueshme pjesa e industrisë së punësimit dhe e bruto prodhimit vendor, në përputhje me kushtet e vendit dhe të dyfishohet kontributi i këtij sektori në vendet më pak të zhvilluara.</p>	<p>18. Përmirësimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar</p>
	<p>9.1 Të zhvillohet një infrastrukturë cilësore, e sigurt, e qëndrueshme dhe rezistente, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve, me fokus qasjen e përballueshme dhe të barabartë për të gjithë.</p>	<p>29. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore</p>
<p><b>10</b> ZVOGËLIM IPABARAZIVE</p> 	<p>10. Të inkurajohet ndihma zyrtare për zhvillim dhe lëvizjet financiare, përfshirë investimet e huaja direkte, për shtetet ku nevoja është më e madhe, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, vendet afrikane, shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim dhe vendet në zhvillim pa dalje në det, në përputhje me planet dhe programet e tyre kombëtare.</p>	<p>19. Promovimi i IHD-ve dhe rritja e rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik</p>
<p><b>12</b> KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM</p> 	<p>12.5 Deri në vitin 2030, reduktim i theksuar i gjenerimit të mbeturinave përmes parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.</p>	<p>34. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave</p>
<p><b>15</b> JETA NË TOKË</p> 	<p>15.1 Deri në vitin 2020, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe i ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe shërbimet e tyre, veçanërisht pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.</p>	<p>33. Menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve</p>
<p><b>17</b> PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT</p> 	<p>17.6 Të intensifikohet bashkëpunimi rajonal, bashkëpunimi ndërkombëtar, bashkëpunimi veri-jug, bashkëpunimi jug-jug dhe bashkëpunimi triangular për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe qasja në to, dhe të forcohet shkëmbimi i njohurive për kushte të rëna dakord reciprokisht, përfshirë edhe përmes koordinimit të përmirësuar ndërmjet mekanizmave ekzistues, në veçanti në nivelin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe përmes mekanizmit global lehtësues për teknologjinë</p>	<p>30. Vendosja e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit</p>

Përveç kësaj, katër tregues të OZHQ-së që kontribuojnë në OZHQ-1 dhe OZHQ-8 janë në përputhje me treguesit e nivelit makro të SKZH-së. Tabela 3 shfaq mënyrën se si OZHQ-të dhe treguesit e nivelit makro të SKZH-së janë të harmonizuara.

**TABELA 3.** Harmonizimi i treguesve të OZHQ-së me treguesit e nivelit makro të SKZH-së

Synimet	Treguesit e OZHQ-së	Treguesit e SKZH-së
<p><b>1 PA VARFËRI</b></p> 	1.2 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet të paktën përgjysmë përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave, që jetojnë në varfëri, në të gjitha dimensionet e saj, në bazë të përcaktimeve kombëtare.	Përqindja e popullsisë që jeton në varfëri
<p><b>8 PUNË DINJITOE DHE RRRITJE EKONOMIKE</b></p> 	8.1 Të mbështetet rritja ekonomike për kokë banori në përputhje me kushtet kombëtare dhe në veçanti, për vendet më pak të zhvilluara kjo rritje të jetë të paktën 7 % e bruto prodhimit vendor në vit.	Norma vjetore e rritjes së BPV-së reale për kokë banori
	8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denja për të gjithë gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagesë të barabartë për punën me vlerë të njëjtë.	Përqindja e papunësisë Shkalla e papunësisë së të rinjve
	8.6 Deri në vitin 2020, të zvogëlohet ndjeshëm përqindja e të rinjve të papunë, të paarsimuar apo të patrajnuar	Përqindja e të rinjve (të moshës 15-24 vjeç) që nuk janë të punësuar, as në shkolim, as në trajnim

### 4.3. Disponueshmëria e të dhënave për të matur progresin e OZHQ-së

Në dy vitet e para të zbatimit të SKZH-së, janë raportuar të dhëna për matjen e progresit për të gjitha OZHQ-të e harmonizuara (plotësisht ose pjesërisht), me përjashtim të të dhënave për matjen e progresit drejt OZHQ-2 (Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme), për të cilën nuk janë raportuar të dhëna. Në nivelin e synuar të OZHQ, janë raportuar të dhëna për 11 nga 22 synime të harmonizuara të OZHQ-së. Më shumë informata të detajuara në lidhje me harmonizimin e OZHQ-së me shtyllat e SKZH-së janë paraqitur në Shtojcën 3.

### 4.5. Kontributi i SKZH-së në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm

Në përgjithësi, dy vitet e para të zbatimit të SKZH-së shfaqën përmirësime sa i përket zvogëlimit të varfërisë, fuqizimit të grave dhe reduktimit të ndërprerjeve të energjisë, duke llogaritur kontributet e dukshme në arritjen e OZHQ-ve 1, 5 dhe 7. Gjithashtu, progresi i lartë drejt zbatimit të

masave të SKZH-së ka kontribuar tek OZHQ-4 (arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i barabartë); OZHQ-8 (promovimi i rritjes së vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësimin të plotë dhe produktiv dhe të denjë për të gjithë); dhe OZHQ-17 (forcimi i mjeteve të zbatimit dhe revitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm).

#### **OZHQ-1. Pa varfëri**

OZHQ-1 bën thirrje për zhdukjen e varfërisë në të gjitha dimensionet e saj deri në vitin 2030, dhe synimi i OZHQ 1.2 është që, deri në vitin 2030, të zvogëlohet të paktën përgjysmë përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave, që jetojnë në varfëri, në të gjitha dimensionet e saj. SKZH-ja trajton varfërinë e të ardhurave në nivelin makro, duke synuar reduktimin e varfërisë së të ardhurave nga 30% në 2015<sup>14</sup>, në 25% në 2021. Të dhënat më të fundit në dispozicion tregojnë progres të ndjeshëm ndaj këtij synimi, me uljen e varfërisë së të ardhurave në 17.6 % në 2015 nën synimin e SKZH-së prej 25% për vitin 2021. Progresi i bërë në zvogëlimin e varfërisë në të ardhura kontribuon pozitivisht në synimin 1.2 të OZHQ-së, duke llogaritur dimensionin e të ardhurave sa i përket varfërisë, i cili matet nga treguesi 1.2.1 i OZHQ-së.

#### **OZHQ-2. Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme**

OZHQ-2 bën thirrje për zgjidhje të qëndrueshme për t'i dhënë fund urisë në të gjitha format e saj dhe të arrihet siguria ushqimore deri në vitin 2030. Rritja e produktivitetit bujqësor është një element kyç që kontribuon në arritjen e këtij synimi, me synimin 2.3 që ka për qëllim dyfishimin e produktivitetit bujqësor në përputhje me SKZH-në. SKZH-ja adreson bujqësinë në Shtyllën 3, me fokus në infrastrukturën bujqësore në shërbim të agrobiznesit dhe synon të rrisë vlerën e shtuar bruto të prodhimit bujqësor nga 10.5% në 2015 në 60% në 2021. Progresi i bërë drejt synimit të SKZH-së dhe kontributi i saj në kontekstin e SKZH-ve nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave në dispozicion për këtë masë.

#### **OZHQ-4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës**

OZHQ-4 bën thirrje për arsim cilësor për të gjithë, duke filluar që në moshe shumë të hershme dhe i cili siguron arsim gjatë gjithë jetës. Çelës për arritjen e këtij synimi do të jetë sigurimi i qasjes në zhvillimin e hershëm fëmijëror, kujdesin dhe arsimin parashkollor deri në vitin 2030 (synimi 4.2 i OZHQ-së); rritja e ndjeshme e numrit të mësimdhënësve të kualifikuar (synimi 4.c i OZHQ-së) rritja e rezultateve efektive të të nxënësve (synimi 4.1 i OZHQ-së). Rëndësia e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor është adresuar nën shtyllën 1 të SKZH-së për kapitalin njerëzor. Fokusi i saj kryesor është rritja e regjistrimit parafillor dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit, duke përmirësuar llogaridhënien, certifikimin dhe planifikimin e buxhetit, në përputhje me objektivat e SKZH-së të përmendura më lartë.

<sup>14</sup> Bazuar në të dhënat e raportuara në vitin 2011.

Të dhënat më të fundit në dispozicion tregojnë një tendencë të rritjes së regjistrimit parashkollor, me regjistrim vjetor prej 10% në vitin 2016 dhe 6% në vitin 2017. Regjistrimi parashkollor ka shënuar progres të lehtë drejt synimit të SKZH-së prej 50% deri në vitin 2021, duke u rritur nga niveli bazë prej 30.9% në vitin 2015 në 36% në vitin 2017. Progres i avancuar është vërejtur për regjistrimin e arsimit parafillor, i cili u rrit nga 81.3% në 2015 në 92% në vitin 2017, me qëllim të arritjes së regjistrimit universal (100%) dhe në përputhje me synimin 4.2 për qasje universale në arsimin parafillor. Në përgjithësi, progresi i raportuar për masat që lidhen me arsimin kanë kontribuar pozitivisht drejt arritjes së synimit 4.2 të OZHQ-së.

Megjithatë, nuk janë raportuar të dhëna mbi kualifikimet e mësimdhënësve dhe arritjet e studentëve, duke e bërë të pamundur matjen e progresit drejt synimeve të SKZH-së ose synimeve 4.c dhe 4.1 të OZHQ-së.

#### **OZHQ-5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave**

OZHQ-5 synon të drejta të barabarta dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave si një temë ndërsektoriale që është pjesë përbërëse e të gjitha dimensioneve të një agjende të zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Të drejtat pronësore dhe pronësia midis grave dhe vajzave, ndër të tjera, është element kyç drejt arritjes së kësaj OZHQ-je. Kjo gjë pasqyrohet në synimin 5.a, i cili kërkon reforma në mënyrë që t'u jepen grave të drejta të barabarta për burimet ekonomike dhe qasjen në pronësi dhe kontroll mbi tokën, duke përfshirë edhe forma tjera pronësore. Mos-barazitë gjinore në Kosovë i kanë lënë gratë në një pozitë jo të favorshme në shoqëri, veçanërisht sa i përket pjesëmarrjes në tregun e punës dhe qasjes në mundësitë ekonomike, të cilat janë të kufizuara me pjesëmarrje të ulët në zotërimin e pronës.<sup>15</sup> Duke marrë parasysh këtë kontekst, dhe në përputhje me synimin 5.a të SKZH-së, OZHQ-ja trajton barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave si një çështje ndërsektoriale, si dhe më saktësisht sipas Shtyllës 2 - qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit.

Tashmë, synimi i SKZH-së për rritjen e zotërimit të pronave midis grave dhe vajzave me 25% deri në vitin 2021, është arritur, me rritjen e zotërimeve të pronave nga ana e grave prej 15.2% që ishte në vitin 2015, në 20% në vitin 2017. Ky progres i arritur do të kontribuoj pozitivisht në arritjen e synimit 5.a të OZHQ-së, megjithëse përpjekjet duhet të vazhdojnë në mënyrë që të rritet edhe më shumë pronësia e grave dhe të sigurohet që të gjitha gratë dhe vajzat mund të gëzojnë të drejtat e tyre në lidhje me zotërimet e pronës.

#### **OZHQ-6. Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimit për të gjithë**

Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm njeh qasjen në ujë të sigurt dhe kanalizime, duke përfshirë menaxhimin e duhur të ekosistemeve të ujërave të ëmbla, si thelbësore për shëndetin e njeriut, qëndrueshmërinë mjedisore dhe prosperitetin ekonomik. Synimi i OZHQ 6.1. synon qasjen uni-

<sup>15</sup> Grupi i Bankës Botërore, 'Promovimi i qasjes së grave në mundësitë ekonomike', <<http://documents.worldbank.org/curated/en/602391521457602814/pdf/124362-PN-P144969-PUBLIC-KSVGGenderPolicyNote.pdf>>, qasur më 3 tetor 2018.

versale dhe të barabartë në ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030. Ngjashëm, racionalizimi i përdorimit të ujit dhe kapacitetet e rritura të burimeve ujore trajtohen në kuadër të Shtyllës 4 të SKZH, e cila fokusohet në infrastrukturën e përmirësuar si një rrugë drejt zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit dhe ekosistemit.

Bazuar në të dhënat e disponueshme, është vërejtur progres i vogël në lidhje me mbulimin e rrjetit të ujësjellësit, i cili u rrit nga 76 përqind në vitin 2015 në 79 përqind në vitin 2017, duke iu afruar objektivit të SKZH i cili është 84 përqind deri në vitin 2021. Ky progres i vogël gjithashtu përfaqëson kontribut premtues ndaj synimit të OZHQ, i cili përcakton një synim më ambicioz për vitin 2030, duke bërë thirrje për qasje universale dhe të barabartë në ujë të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë

#### **OZHQ-7. Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë**

Qasja në energji të përballueshme, të sigurt dhe të qëndrueshme është vendimtare për arritjen e shumë OZHQ-ve, nga çrrënjësia e varfërisë nëpërmjet avancimeve në shëndetësi, arsim, ujësjellës dhe industrializim, për të lehtësuar ndryshimet klimatike. Synimet e OZHQ 7.1 dhe 7.2 - qasja universale në shërbimet energjetike dhe rritja në mënyrë substanciale e pjesës së energjisë së ripërtërishme brenda portofolios së prodhimit të energjisë - janë kyçe për të siguruar qasje në energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë, të cilat do të jenë vendimtare për rritjen ekonomike në të ardhmen në Kosovë. SKZH adreson këtë komponent si pjesë të Shtyllës 4 për infrastrukturë.

SKZH synon të reduktojë ndërprerjet e energjisë nga 384 orë në vit në vitin 2015 në 192 orë në vit deri në vitin 2021; dhe më pas të rrisë pjesën e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme, nga 19.8 përqind në vitin 2015 në 25 përqind në vitin 2021. Synimi i SKZH për reduktimin e ndërprerjeve të energjisë është arritur tashmë dhe trendi pozitiv paraqet progres drejt synimit të OZHQ 7.1. Megjithatë, ka mungesë të të dhënave për pjesën e energjisë së prodhuar nga shërbimet e ripërtërishme, duke e bërë të pamundur vlerësimin e progresit drejt këtij synimi. Përpjekjet duhet të vazhdojnë drejt arritjes së qasjes universale në shërbimet e përballueshme, të sigurt dhe moderne energjetike deri në vitin 2030.

#### **OZHQ-8. Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë**

OZHQ-8 bën thirrje për rritjen e produktivitetit të punës, uljen e shkallës së papunësisë, veçanërisht për të rinjtë dhe përmirësimin e qasjes në shërbime financiare dhe përfitime si komponentë thelbësorë të rritjes ekonomike të pandërprerë dhe gjithëpërfshirëse. Në mënyrë të ngjashme, SKZH fokusohet në rritjen e mundësive për punësim, veçanërisht në mesin e të rinjve, të cilët përbëjnë rreth gjysmën e popullsisë së përgjithshme të Kosovës.<sup>16</sup> Nxitja e rritjes ekonomike të

<sup>16</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrimi i Popullsisë, 2011

qëndrueshme nëpërmjet punësimit produktiv dhe punës së denjë për të gjithë është në qendër të SKZH.

Synimet kyçe që orientojnë arritjen e OZHQ-8 që janë në përputhje me objektivat e SKZH përfshijnë: mbështetjen e rritjes ekonomike për kokë banori (synimi 8.1); promovimin e politikave të orientuara drejt zhvillimit që mbështesin aktivitetet prodhuese (synimi 8.3); punësimin e plotë dhe produktiv deri në vitin 2030 (synimi 8.5); reduktimin në mënyrë substanciale të përqindjes së të rinjve që nuk janë pjesë e arsimit, punësimit ose trajnimit deri në vitin 2020 (synimi 8.6); dhe mbrojtjen e të drejtave të punës dhe mjedisit të sigurt të punës (synimi 8.8).

Në vitin e dytë të zbatimit të SKZH, Kosova u ballafaqua me progres të kufizuar të realizuar në rritjen e normës së përgjithshme të rritjes vjetore të BPV reale për kokë banori dhe uljes së normës së përgjithshme të papunësisë. Nga ana tjetër, është vërejtur progres i avancuar drejt zvogëlimit të përqindjes së të rinjve që nuk janë në arsim, punësim apo trajnim. Për më shumë informacion të detajuar, referojuni pjesës 1.2. Progresi drejt arritjes së objektivave kryesore të SKZH.

Papunësia mes të rinjve që kanë përfunduar arsimin profesional gjithashtu ka pasur progres të kufizuar, me një rënie të vogël prej 35.9 përqind në vitin 2015 në 33 përqind në vitin 2017. Asnjë progres nuk është vërejtur në punësimin e përgjithshëm joformal, të treguar nga përqindja e punëtorëve që punojnë pa kontratë me një rritje negative nga 15.5 përqind në vitin 2015 në 21.5 përqind në vitin 2017, kundrejt objektivit të SKZH prej 12 përqind në vitin 2021. Siguria në vendin e punës është ende e brishtë, duke pasur parasysh se numri i lëndime fatale dhe jo fatale në punë është rritur në numra absolut, nga 54 në vitin 2015 (9 lëndime fatale dhe 45 lëndime jo-fatale) në 64 në vitin 2017 (14 lëndime fatale dhe 50 lëndime jo-fatale). Të dhënat tregojnë se megjithëse pjesëmarrja e fuqisë punëtore dhe shkalla e punësimit janë përmirësuar, ky komponent i SKZH ka pasur progres të kufizuar në përgjithësi me kontribute të kufizuara ose mungesë të tyre në lidhje me OZHQ.

### **OZHQ-9. Ndërtimi i infrastrukturës së qëndrueshme, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit**

OZHQ-9 trajton infrastrukturën, industrializimin dhe inovacionin. Infrastruktura ofron objektet themelore fizike të domosdoshme për biznesin dhe shoqërinë; industrializimi nxit rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, duke reduktuar kështu papërcaktueshmëri në të ardhura; dhe inovacioni zgjeron aftësitë teknologjike të sektorëve industrialë dhe nxit zhvillimin e aftësive të reja.

SKZH fokusohet në infrastrukturën dhe industrializimin nën Shtyllën 3 dhe 4 - industritë konkurruese. Ajo synon të rrisë mbështetjen e shtetit për procesin e ri-industrializimit dhe të forcojë ndërmarrjet publike dhe private. Disa nga synimet që udhëheqin arritjen e OZHQ-9 dhe janë në përputhje me SKZH janë: qasja e rritur në shërbimet financiare për industrinë e vogla dhe ndërmarrjet e tjera (synimi 9.3 i OZHQ); rritja në mënyrë të konsiderueshme e pjesëmarrjes së indus-

trisë në punësim dhe BPV deri në vitin 2030 (synimi 9.2 i OZHQ); dhe zhvillimi i infrastrukturës cilësore, të sigurt, të qëndrueshme dhe fleksibile, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare (synimi 9.1 i OZHQ).

Të dhënat në dispozicion tregojnë progres të kufizuar drejt rritjes së numrit të kredive për NVM-të e mbështetura nga skema e garancisë së kredisë, nga 0 në vitin 2015 në 699 në vitin 2017, kundrejt objektivit të SKZH prej 4.150 deri në vitin 2021. Megjithatë, është vërejtur një progres i vogël në kontributin e industrisë në ekonomi, që u rrit nga 10.8 përqind në vitin 2015 në 11.5 përqind në vitin 2017, kundrejt objektivit 14 përqind të caktuar për 2021 dhe me një kontribut të vogël ndaj synimit 9.3 të OZHQ.

Në aspektin e transportit, vëllimi i transportit të mallrave tregon progres të vogël, duke u rritur nga 0.154 milion ton neto në vitin 2015 në 0.434 milion ton neto në vitin 2017, kundrejt objektivit prej 1.433 milion ton neto në vitin 2021. Transporti hekurudhor në Kosovë nuk është i shfrytëzuar mjaftueshëm për transportin e mallrave dhe pasagjerëve. Të dhënat më të fundit në dispozicion tregojnë një trend negativ, me transportin e udhëtarëve duke u zvogëluar nga 0.183 milion pasagjerë në vitin 2015 në 0.157 milion pasagjerë në vitin 2017, kundrejt objektivit të SKZH prej 0.432 milion pasagjerë në vitin 2021.

Progresi drejt vlerës së shtuar (bruto) të NVM-ve (si përqindje e BPV) nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.

### **OZHQ-10. Zvogëlimi i pabarazisë brenda dhe mes vendeve**

OZHQ-10 bën thirrje për reduktimin e pabarazisë brenda dhe mes vendeve në të gjitha format e saj, duke përfshirë pabarazinë në të ardhura dhe pabarazitë e bazuara në gjini, moshë, paaftësi, klasë, përkatësi etnike, fe dhe mundësi. Çelësi për arritjen e këtij qëllimi është inkurajimi i ndihmës zyrtare për zhvillim dhe flukset financiare, duke përfshirë IHD për vendet në nevojë. Shtylla 3 e SKZH - industritë konkurruese - adreson IHD dhe kontribuon në synimin 10.b të OZHQ. Megjithatë, të dhënat në dispozicion tregojnë se nuk është bërë progres në drejtim të rritjes së vëllimit të hyrjeve të investimeve të huaja, me një rënie prej 11 përqind nga 2015 në 2017.

### **OZHQ-12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit**

OZHQ-12 bën thirrje për minimizimin e burimeve natyrore dhe materialeve toksike të përdorura, duke përfshirë mbetjet e krijuara, gjatë proceseve të prodhimit dhe konsumit. Menaxhimi i mbeturinave është trajtuar në Shtyllën 4 të SKZH për infrastrukturën, e cila synon të parandalojë që mbetjet të ndikojnë në mjedis. Synimi 12.5 i OZHQ, i cili është në përputhje me SKZH, fokusohet në zvogëlimin substancial të prodhimit të mbetjeve përmes parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit deri në vitin 2030. Përderisa SKZH synon të rrisë riciklimin e mbetjeve nga 25 përqind në 2015 në 40 përqind 2021, aspak progres nuk është vërejtur deri më sot.



**OZHQ-15. Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i pyjeve në mënyrë të qëndrueshme, luftimi i shkretëtirëzimit si dhe ndalimi dhe kthimi i degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit**

OZHQ-15 trajton menaxhimin e pyjeve në mënyrë të qëndrueshme, duke luftuar shkretëtirëzimin, ndalimin dhe kthimin e degradimit të tokës dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit. SKZH trajton menaxhimin dhe përdorimin e pyjeve nën Shtyllën 4 për infrastrukturën. Të dy synimet e SKZH dhe OZHQ-15 (synimi 15.1 i OZHQ) përqendrohen në menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve, midis elementëve të tjerë. Sidoqoftë, nuk janë raportuar të dhëna për vlerën e shtuar bruto të prodhimit bujqësor deri më sot.

**OZHQ-17. Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm**

Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm bën thirrje për partneritete të zgjeruara globale që bashkojnë të gjithë akterët dhe mobilizojnë të gjitha burimet drejt arritjes së OZHQ-ve. Në mënyrë të ngjashme, SKZH njih rëndësinë e partneriteteve në kontekstin e vendosjes së infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. OZHQ-17 thekson mekanizmin global të lehtësimit të teknologjisë si një mjet për të zgjeruar partneritetet ndërkombëtare, në përputhje me SKZH.

Gjatë dekadës së fundit, Kosova gjithnjë e më shumë e ka përdorur teknologjinë e informacionit për zhvillimin e biznesit dhe ka integruar këto teknologji në ekonominë më të gjerë. SKZH njih nevojën për të nxitur më tej infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të ulur kostot operacionale të biznesit, për të rritur investimet dhe për të rritur inovacionin. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit është gjithnjë e më e qasshme për popullsinë, me përqindjen e banorëve të cilët kanë qasje në një rrjetit fiks brezgjërë duke u rritur nga 75 përqind në vitin 2015 në 92.5 përqind në vitin 2017, në rrugën e duhur për të arritur objektivin prej 100 përqind deri në vitin 2021. Ky progres po kontribuon në synimin 15.1 të OZHQ, i cili synon qasjen universale deri në vitin 2020.



# 5.

## HAPAT E ARDHSHËM

Siç është dokumentuar në të gjithë këtë raport, progres është arritur tashmë në shumicën e masave të SKZH dhe rezultatet fillestare po shfaqen. Megjithatë, jemi ende larg arritjes së zbatimit të plotë dhe përpjekjet për zbatimin duhet të rriten për të kryer të gjitha aktivitetet e planifikuara deri në vitin 2021. Masat e SKZH gjithashtu duhet të integrohen plotësisht në kornizën e planifikimit buxhetor dhe në planin vjetor të punës të Qeverisë (PVPQ), dhe funksionimi i Sistemit të Planifikimit të Integruar brenda ministrive të linjës duhet të përmirësohet. Raportet e monitorimit, të cilat Zyra e Planifikimit Strategjik i ofron rregullisht, duhet të ndiqen nga veprime për të reduktuar vonesat dhe për të siguruar zbatimin efektiv. Disa prej masave do të ju duhet përditësim për të përmirësuar rezultatet dhe ndikimin e tyre.

### 5.1. Përmirësimi i zbatimit

#### Integrimi i plotë i masave të SKZH në planin vjetor të punës së Qeverisë

Janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të integruar aktivitetet dhe nën-aktivitetet e planifikuara në Udhërrëfyesit e SKZH në PVPQ për vitin 2017 dhe 2018. Megjithatë, kanë mbetur disa mospërputhje dhe këto duhet të trajtohen gjatë përgatitjes së PVPQ për vitin 2019 nga Zyra e Kryeministri (Sekretariati Koordinues i Qeverisë dhe Zyra e Planifikimit Strategjik) dhe grupet teknike të punës, duke përfshirë ministrinë e linjës. Aty ku është e nevojshme, nën-aktivitetet e planifikuara në Udhërrëfyesin e SKZH për vitin 2019 do të duhet të rregullohen në PVPQ për atë vit për të trajtuar vonesat e zbatimit.

Informacioni i paraqitur në këtë raport të parë u mblodh direkt nga ministrinë e linjës që zbatojnë masat e SKZH. Sidoqoftë, sapo të përfshihen të gjitha aktivitetet dhe nën-aktivitetet e SKZH, të planifikuara për vitin aktual, në PVPQ, marrëveshjet ekzistuese të raportimit për PVPQ mund të përdoren për monitorim të rregullt të progresit me zbatimin e SKZH. Kjo qasje, e cila ka për qëllim zvogëlimin e barrës së raportimit për ministrinë e linjës, do të kërkonte që treguesit e prodhimit të përdorur për aktivitetet në PVPQ të jenë të njëjtë si në Udhërrëfyesit e SKZH, por të ndarë në objektiva vjetorë. Ministrinë do të duhet të japin informacion mbi progresin drejt këtyre objektivave kur raportojnë mbi zbatimin e PVPQ gjatë vitit.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë ka planifikuar që afati kohor për pjesën strategjike të PVPQ të zgjatet deri në tre vjet. Kjo do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e planifikimit dhe zbatimit. Pjesa më e madhe e aktivitetëve të SKZH, nëse jo të gjitha, duhet të përfshihen në pjesën strategjike të PVPQ për të theksuar prioritetin e tyre për Qeverinë. Për më tepër, nëse kostohen të gjitha aktivitetet (jo vetëm ato në lidhje me SKZH)

në pjesën strategjike të PVPQ, shuma e kostove të tyre do të informojë Ministrinë e Financave për fondet e përgjithshme buxhetore që duhet të ndahen për zbatimin e prioriteteve kyçe të Qeverisë.

### **Integrimi i plotë i masave të SKZH në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe në Buxhet**

Vështirësitë në sigurimin e lidhjes midis kostimit dhe planeve të financimit për masat e SKZH dhe dokumentet e planifikimit buxhetor, si dhe raportimi i kostove që lidhen me zbatimin e masave të SKZH rrjedhin nga struktura aktuale e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Tabelat e Ligjit për Buxhetin. Një numër i konsiderueshëm i objektivave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të sektorëve buxhetorë tashmë përfshijnë shumicën e objektivave të masave të SKZH. Sidoqoftë, formati aktual për paraqitjen e tavaneve të buxhetit sektorial në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve nuk e bën të dukshme financimin e prioriteteve. Kjo është për shkak se:

- a)** Planifikimi i buxhetit sektorial paraqitet vetëm në nivele të përgjithshme dhe sipas kategorive ekonomike, jo në aspektin e programeve dhe politikave;
- b)** Edhe pse buxheti paraqitet formalisht në nivel programesh dhe nën-programesh, nën-programet pasqyrojnë buxhetet e departamenteve përkatëse dhe jo masat e politikave.

Në këtë kontekst, qasja aktuale e buxhetimit bazohet më shumë në prioritizimin e institucioneve dhe jo në prioritizimin e politikave/programeve. Kjo do të thotë se buxhetimi nuk lejon matjen e drejtpërdrejtë të inputeve që lidhen me realizimin e një politike/programi dhe kosto përkatëse. Një situatë e tillë vë në dyshim efektivitetin e shpenzimeve publike dhe pengon matjen e suksesit/performancës së një politike të caktuar kundrejt fondeve të shpenzuara në atë politikë. Struktura e paraqitur gjithashtu e bën të vështirë identifikimin e saktë të fondeve të shpenzuara në një politikë/prioritet të dhënë.

I vetmi përjashtim nga kjo është buxheti kapital që liston të gjitha projektet kapitale me emrat e tyre dhe siguron informata për alokimet buxhetore dhe fondet për secilin projekt. Kjo ishte e qartë edhe në raportimin e ministrisë së linjës. Raportimi mbi kostot e bëra ishte më i saktë për projektet e infrastrukturës.

Duke pasur parasysh kufizimet ligjore të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kalimi nga niveli aktual i planifikimit dhe buxhetimit në buxhetimin në nivel programi kërkon kohë dhe kërkon ndryshime në Ligj. Kjo tregon nevojën për një strukturë që është në harmoni me legjislacionin ekzistues dhe nuk paraqet ndonjë pengesë për të bërë ndryshime/plotësime në nivelin e organizatave buxhetore për të siguruar lidhje më të mirë ndërmjet politikave dhe buxheteve, duke llogaritur standardet e mira të buxhetit. Kjo do të lejonte raportime më të sakta dhe më të lehta për zbatimin e politikave/programeve. Përmirësime të tilla mund të jenë si më poshtë:

- a)** Lidhja midis strukturës së buxhetit dhe objektivave strategjike të sektorit;
- b)** Përparimi i mëtejshëm i procesit të planifikimit strategjik të sektorit.

Kështu që, është e mundur të përmirësohet vlera e informacionit të paraqitur në buxhet pa kaluar nëpër format e buxhetimit të bazuara në program, që konsiderohet si një detyrë e vështirë edhe nga qeveritë e vendeve të zhvilluara. Për të adresuar këtë sfidë, do të ishte e përshtatshme që gjatë hartimit të buxhetit vjetor të përfshihen linja të ndara buxhetore për aktivitetet e SKZH në nën-programet e ministrive të linjës që po zbatojnë aktivitete të caktuara të SKZH. Ngjashëm me procesin e kostimit të masave të SKZH, ministrinë e linjës mund të përdorin modelin e zhvilluar të kostos.

Kjo zgjidhje e mundshme do të bënte financimin e buxhetit të masave dhe aktiviteteve të SKZH më transparent dhe të identifikueshëm. Kjo do të mundësonte krahasimin e buxheteve aktuale dhe të planifikuara me kostot e vlerësuara të aktiviteteve të SKZH. Një planifikim i tillë buxhetor, i cili identifikon kostot e aktiviteteve të SKZH nga linja individuale, do të mundësonte një raportim më të lehtë të kostos.

### **Integrimi i masave të SKZH në dokumentet kyçe që lidhen me integrimin në Bashkimin Evropian**

Shkalla në të cilën masat e SKZH mund të integrohen në dokumentet për anëtarësim në Bashkimin Evropian varet nga qëllimi dhe struktura e këtyre dokumenteve. Dokumenti i cili ka të bëjë më shumë me SKZH është Programi vjetor i Reformës Ekonomike (PRE). Ekziston tashmë një nivel i lartë i konsistencës ndërmjet reformave strukturore në PRE dhe atyre masave të SKZH që lidhen me të njëjtën fushë të politikës. Fusha kryesore për përmirësim është shkalla në të cilën aktivitetet e planifikuara për zbatimin e masave të ndërlidhura janë të harmonizuara në PRE dhe SKZH.

Përveç kësaj, analizat kanë treguar se nga 20 masat e PRE, 12 janë të harmonizuara me OZHQ-të pasi ato janë të lidhura direkt me masat e SKZH. 5 masa të tjera të PRE janë gjithashtu të njëjta me OZHQ-të edhe pse ato ndryshojnë nga SKZH. Kjo tregon se arritja e PRE dhe SKZH në vetvetë do të kontribuojnë në OZHQ-të duke lejuar dëshmi të matshme të këtij progresi me të dhënat e mbledhura.

Dokumenti më i rëndësishëm i integritit në Bashkimin Evropian është Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). PKZMSA ofron një plan gjithëpërfshirës për përafrimin ligjor dhe ndërtimin e institucioneve në të gjithë kapitujt e Acquis, si dhe politikat dhe masat për të përmbushur kriteret e Kopenhagës për anëtarësim. Kapitulli i PKZMSA në lidhje me kriteret ekonomike duhet të përafrohet ngushtë me PRE dhe t'i referohet masave përkatëse të SKZH.

Për të shfrytëzuar plotësisht MSA dhe të gjitha mundësitë që ofron, Qeveria e Kosovës dhe Bashkimi Evropian ranë dakord të zhvillojnë një Agjendë të Reformave Evropiane, e cila përfshin përparësitë afatshkurtra në fushat e (I) qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, (II) konkurrencës dhe klimës së investimeve dhe (III) arsimit dhe punësimit. Kështu, ARE do të shërbejë si një doku-

ment që do t'i japë përparësi reformave kryesore ekonomike siç përcaktohet në PRE dhe SKZH. Veprimet prioritare sipas Agjendës së Reformave Evropiane janë identifikuar bashkërisht nga qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian në konsultim të ngushtë me IFN-të, sektorin e biznesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë.

Një tjetër grup i rëndësishëm i dokumenteve të integritimit në Bashkimin Evropian janë ato që lidhen me programimin e asistencës financiare para anëtarësimit. Prioritetet e tyre duhet të përfshijnë objektivat dhe aktivitetet e masave të SKZH, veçanërisht ato për të cilat është krijuar boshllëku i financimit në udhërrëfyesit e SKZH.

### **Koordinimi i planifikimit të politikave dhe proceseve të buxhetimit brenda ministrive të linjës**

Konsistenca e dokumenteve të politikave dhe planifikimit buxhetor të koordinuara në nivel të Qeverisë varet në mënyrë të vendosur në cilësinë dhe konsistencën e inputeve të ofruara nga ministrinë e linjës. Inputet për dokumentet e ndryshme (d.m.th. SKZH, PRE, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, PKZMSA, Programi i IPA dhe PVPQ) janë përgatitur në njësi të ndryshme të ministrisë, të cilat shpesh çojnë në mospërputhje midis prioriteteve dhe masave të artikuluar në këto dokumente të ndryshme. Më e rëndësishmja, prioritetet e ministrive të linjës, siç paraqiten në SKZH, rrallëherë janë të prioritizuara në kërkesat buxhetore të ministrive ose në parashtrimet e tyre për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Mënyra më e mirë për të trajtuar këtë çështje është forcimi i strukturave ekzistuese të koordinimit brenda ministrive të linjës, përkatësisht departamenteve të integritimit evropian dhe koordinimit të politikave dhe grupeve të menaxhimit strategjik. Këto departamente duhet të veprojnë si rojtarë të brendshëm për të siguruar qëndrueshmëri midis parashtrësive të ministrive për dokumente të ndryshme qeveritare.

## **5.2. Përmirësimi i marrëveshjeve të monitorimit dhe raportimit**

### **Përmirësimi i monitorimit të kostove të zbatimit të SKZH**

Raportimi i hollësishëm i kostove i kërkuar nga metodologjia e raportimit të SKZH kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis zyrtarëve përgjegjës për planifikimin e politikave dhe atyre që punojnë në departamentet e planifikimit financiar dhe të buxhetit të ministrisë së linjës.

Përveç kësaj, ekziston nevoja për të rritur koordinimin ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Zyrës së Planifikimit Strategjik për raportimin e kostove ndaj aktiviteteve të zbatuara. Mbështetje dhe udhëzime të mëtejshme duhet t'u ofrohen ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera për të përmirësuar raportimin mbi kostot e masave të zbatuara. Takimet dypalëshe midis politikë-bërësve dhe zyrtarëve financiarë të ministrive të linjës do të lehtësonin identifikimin e kostos së zbatuar përmes konsultimit të dokumenteve buxhetore në krahasim me planifikimin e bërë në modelin e kostos.

Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe konsistencën e procesit, është e rëndësishme të përfshihen të njëjtët akterë të përfshirë në procesin e kostimit të masave të SKZH në procesin e raportimit të kostos, në atë masë që është e mundur. Kjo do të ndihmonte në harmonizimin e proceseve të kostimit dhe raportimit të kostos, gjë që do të përmirësonte cilësinë e raportimit.

Kjo qasje do të adresonte disa nga problemet e identifikuar, duke përfshirë ato që lidhen me: 1) mungesën e raportimit të kostove në rastet kur raportohet zbatimi i aktivitetit; 2) raportimin e vlerave të buxhetuara kundrejt fondeve të shpenzuara; dhe 3) kostot e raportuara të rëna dukshëm nën kostot e planifikuara.

### **Përmirësimi i treguesve të rezultateve për masat e SKZH**

Procesi i identifikimit të treguesve për monitorimin e rezultateve të SKZH ishte e kufizuar në disa raste nga mungesa e të dhënave shumë relevante. Prandaj, është bërë gjithnjë e më e rëndësishme që të mbyllet boshllëqet më të theksuara të të dhënave - jo vetëm për të adresuar nevojat e monitorimit të SKZH, por edhe për të përmbushur kërkesat e Bashkimit Evropian për PRE e ardhshme, që do të përfshijë një sërë treguesish të performancës për secilën masë prioritare të reformës strukturore. Treguesit e përdorur në këtë raport mund të përdoren gjithashtu për shumë nga masat e PRE, dhe disponueshmëria e të dhënave shtesë mund të ndihmojë në përmirësimin e përzgjedhjes së treguesve dhe të rrisë rëndësinë e tyre dhe krahasueshmërinë ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh rëndësinë e inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit për rritjen e vlerës së shtuar dhe konkurrencës së eksportit të ekonomisë së Kosovës, ekziston një nevojë urgjente për të dhëna statistikore të besueshme për këto aktivitete. Eurostat ka zhvilluar një grup të standardizuar të treguesve për aktivitetet kërkimore, zhvillimore dhe inovative dhe do të ishte një ndihmë e madhe për zhvillimin e politikave dhe vendimeve nëse Agjencia e Statistikave të Kosovës do të zbatojë këtë metodologji të përbashkët për të prodhuar të dhëna të krahasueshme për Kosovën. Treguesit më të rëndësishëm janë shpenzimet (biznesore) publike dhe private për kërkimin dhe zhvillimin, si dhe pjesëmarrjen e ndërmarrjeve inovative në ekonomi.

Investimi është një tjetër nxitës i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Rritja e Kosovës është mbështetur shumë në një përqindje të lartë të investimeve publike në BPV, por investimi i biznesit privat do të jetë po aq i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme. Të dhënat zyrtare për investimet e sektorit privat dhe pjesa e tij në BPV do të siguronin një kuptim më të mirë të nxitësve të rritjes dhe do të lehtësonin monitorimin më efektiv të efekteve të masave të politikave që synojnë nxitjen e investimeve private.

SKZH priorizon mbështetjen e zhvillimit të një sektori dinamik, inovativ dhe të orientuar drejt eksportit për NVM-të. Të dhënat mbi demografinë e biznesit dhe shpërndarjen sektoriale të ndërmarrjeve ofrojnë njëfarë pasqyre në dinamikën e sektorit të biznesit të vogël, megjithëse nevojitet më shumë informacion për performancën e tyre. Të dhëna të detajuara mbi madhësinë e ndërmarrjes duhet të vihen në dispozicion për disa tregues standardë, si vlera e shtuar, punësimi ose eksportet.

Ka disa çështje metodologjike me tregues të veçantë që do të duhet të zgjidhen para raportit të ardhshëm. Për shembull, duhet të sqarohet metodologjia për llogaritjen e kursimeve të energjisë (në drejtim të synimit prej 9 përqind). Aktualisht është shumë e vështirë të dokumentosh kursimet e arritura duke përdorur një metodologji nga poshtë-lart, pasi të dhënat e kufizuara janë në dispozicion. Nëse një qasje nga poshtë-lart është e pamundur, mund të aplikohet një metodologji nga lart-poshtë, duke përdorur nivelin e konsumit total final në ktoe/BPV. Nëse të dhënat statistikore lejojnë, treguesi i njëjtë mund të përdoret edhe në sektorë si ekonomitë familjare, transporti, industria dhe sektorët komercialë. Treguesi i prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike mund të plotësohet nga një tregues për kapacitetin e instaluar të prodhimit të energjisë. Në mënyrë të ngjashme, treguesi për pjesën e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme mund të plotësohet nga një tregues për pjesën e burimeve të ripërtërishme në kapacitetin total të prodhimit.

### 5.3. Përmirësimi dhe ristrukturimi i masave ekzistuese të SKZH

Ky raport mund të shërbejë si bazë për një rishikim afatmesëm dhe rregullime pasuese në SKZH. Përderisa masat që po përparojnë mirë duhet të mbahen dhe të vazhdojnë, një numër i vogël i masave të reja duhet të shtohen për të marrë parasysh sfidat e reja dhe sfidat që nuk janë adresuar siç duhet në SKZH. Për të shmangur rritjen e numrit të përgjithshëm të masave, ato që janë duke përparuar mirë ose kanë provuar të jenë më pak të rëndësishme për arritjen e objektivave të SKZH mund të hiqen nga versioni i rishikuar i SKZH. Rekomandimet specifike janë dhënë më poshtë për secilën Shtyllë të SKZH.

**Shtylla 1 – Kapitali njerëzor: Shtimi i masave për punësim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale**  
Shtylla 1 është pothuajse tërësisht e fokusuar në arsim dhe i mungojnë masat për aspektet tjera të zhvillimit dhe shfrytëzimit të kapitalit njerëzor. Për këtë arsye, mund të shtohen tre masat e mëposhtme:

- 1. Masa për rritjen e punësimit dhe për promovimin e aftësive të jetës dhe të punës: Themelimi i Agjencisë së Punësimit** - e cila është në fazat përfundimtare - do të lejojë zhvillimin dhe zbatimin e një grupi më ambicioz të masave aktive të politikës së tregut të punës. Këto masa duhet të përqendrohen në çështjet më kritike, si rritja e punësimit të rinjve dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore. Masat e reja të SKZH mund të bazohen kryesisht në Planin e Veprimtimit për Punësimin e Rinjve dhe në Strategjinë e ardhshme të Punësimit dhe Mirëqenies Sociale. Financimi për masat e tregut të punës duhet gjithashtu të rritet në mënyrë substanciale për të arritur rezultate kuptimplota.
- 2. Masa për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe qasshmërinë e tyre bazuar në parimin e mos-neglizhimit të të tjerëve:** Qasja në shërbimet shëndetësore do të përmirësohet nga futja e planifikuar e sigurimit universal shëndetësor, i cili do të përfshijë dispozita për subvencionimin e primeve për njerëzit me të ardhura të ulëta dhe për sigurimin e integritetit të parimit të shëndetësisë për mos-neglizhimin e të tjerëve, në përputhje me Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo duhet të plotësohet nga një program për të përmirësuar në mënyrë substanciale cilësinë e shërbimeve që sektori i shëndetësisë publike i ofron për të siguruarit.

### 3. Masa për reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e sistemit të mirëqenies sociale:

Sistemi i mirëqenies sociale duhet të rishikohet për të synuar më mirë personat me të ardhura më të ulëta dhe në rrezik varfërie. Niveli i përfitimeve për këto kategori duhet të rritet gradualisht. Siç është planifikuar tashmë në PRE, duhet të prezantohet një grant i ri komunal për shërbimet sociale për të rritur ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal ku nevojat specifike të njerëzve janë më të lehta për tu njohur dhe trajtuar.

Një masë tjetër që duhet shtuar në Shtyllën 1 është përmirësimi i cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor. Masa e arsimit të lartë që u prezantua në PRE në vitin 2018 është një pikë e mirë fillestare për zhvillimin e një mase më gjithëpërfshirëse për SKZH.

Në lidhje me masat ekzistuese, rekomandohen qasjet e mëposhtme:

- Masa 1 për regjistrimin parashkollor po përparon mirë dhe duhet të vazhdojë. Mund të shtohet një aktivitet tjetër që lidhet me mundësitë e barabarta dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupet e marginalizuara.
- Masa 2 për cilësinë e mësimdhënies dhe Masa 4 për ekzaminimin, inspektimin dhe akreditimin mund të bashkohen në një masë gjithëpërfshirëse për përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar.
- Masa 3 për lidhjen e arsimit me tregun e punës po përparon mirë dhe duhet të vazhdojë.
- Masa 5 për optimizimin e shpenzimeve, e cila është kryesisht një masë organizative dhe e menaxhimit dhe Masa 6 për përfshirjen e mësimdhënësve dhe studentëve të diasporës, e cila është vonuar në zbatim, mund të hiqet nga Shtylla 1 për të liruar hapësirë për futjen e masave të reja të sugjeruara më lartë. Megjithatë, aktivitetet e planifikuara duhet të vazhdojnë si pjesë e aktiviteteve të rregullta të ministrive përgjegjëse të linjës.
- Masa 7 për reduktimin e punësimit joformal ka arritur progres të avancuar. Aktivitetet e mbetura mund të përfshihen në masën e re për reduktimin e ekonomisë joformale nën Shtyllën 2.

Tabela 4 ilustron strukturën e re të shtyllës 1, në rast se këto rekomandime merren parasysh.

**TABELA 4:** Ristrukturimi i shtyllës 1 me masat e rekomanduara

M1. Gjithëpërfshirja në arsimin parashkollor dhe parafillor	Masë ekzistuese
M2. Përmirësim i cilësisë së arsimit parauniversitar	Bashkim i masave ekzistuese 2 dhe 4
M3. Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës	Masë ekzistuese
M4. Edukim i lartë konkurrues dhe hulumtimi	Masë e re
M5. Rritja e punësimit dhe promovimi i aftësive të jetës dhe punës	Masë e re
M6. Mos-neglizhimi i askujt në shërbimet shëndetësore, si dhe shërbime të qasshme dhe cilësore shëndetësore	Masë e re
M7. Sistem efektiv i mirëqenies sociale	Masë e re



## Shtylla 2 – Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit: Shtimi i masave për përmirësimin e integritetit të sektorit publik dhe reduktimin e ekonomisë joformale

Ndonëse përhapja e joformalitetit dhe niveleve të larta të korrupsionit të perceptuar janë pranuar gjerësisht si pengesa të dukshme për rritjen e ekonomisë së Kosovës, ende nuk ka masa specifike për adresimin e këtyre çështjeve në SKZH. Mund të shtohen masat e mëposhtme:

1. Një masë për reduktimin e ekonomisë joformale: Kjo masë mund të zhvillohet bazuar në strategjinë e re për luftimin e ekonomisë joformale, e cila është në përgatitje e sipër. Ajo gjithashtu duhet të integrojë Masën ekzistuese 7 (reduktimi i punësimit joformal) dhe Masën ekzistuese 15 (agjencia e vetme e të hyrave).
2. Një masë për rritjen e integritetit të sektorit publik: Kjo masë duhet të përfshijë aktivitete që synojnë rritjen e transparencës dhe uljen e rreziqeve të korrupsionit në sektorin publik. Ajo duhet të integrojë Masën ekzistuese 10 (për inspektimet) dhe Masën ekzistuese 12 (për prokurimin publik).

Sa i përket masave ekzistuese, rekomandohen metodat e mëposhtme:

- Masa 8 për shërbimet për sektorin e biznesit dhe publikun duhet të vazhdojë.
- Masa 9 për licencat dhe lejet duhet të vazhdohet dhe të zgjerohet me programin e ri për zvogëlimin e përgjithshëm të barrës administrative, që planifikohet të përgatitet.
- Masa 10 për inspektimet dhe Masa 15 për agjencinë e vetme për të hyra duhet të futen në masën e re gjithëpërfshirëse për reduktimin e ekonomisë joformale.
- Masa 11 për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi duhet të vazhdojë.
- Masa 12 për prokurimin publik duhet të futet në masën e re gjithëpërfshirëse për rritjen e integritetit të sektorit publik.
- Masa 13 për të drejtat pronësore duhet të vazhdohet.
- Masa 14 për efikasitetin e gjyqësorit duhet të vazhdojë dhe të zgjerohet me një aktivitet që synon përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, veçanërisht në çështjet ekonomike dhe sociale.

Tabela 5 ilustron strukturën e re të Shtyllës 2, nëse këto rekomandime merren parasysh.

**TABELA 5:** Ristrukturimi i Shtyllës 2 me masat e rekomanduara

M8. Përmirësimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët	Masë ekzistuese
M9. Zvogëlimi i pengesave administrative për licencat dhe lejet	Masë ekzistuese
M10. Reduktimi i joformalitetit	Masë e re
M11. Miratimi i politikave të bazuara në të dhëna	Masë ekzistuese
M12. Integriteti i sektorit publik	Masë e re
M13. Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore	Masë e re
M14. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve	Masë ekzistuese



### Shtylla 3 – Industritë konkurruese: Shtimi i masave për inovacionin, konkurrencën e eksportit dhe zhvillimin e balancuar rajonal

Kjo shtyllë ofron një sërë masash për NVM-të, por nuk përmban ndonjë masë të fortë për zhvillimin industrial dhe konkurrencën e përgjithshme të ekonomisë. Masat e mëposhtme mund të shtohen për të plotësuar këtë boshllëk:

1. Një masë për rritjen e konkurrueshmërisë së eksportit: Kjo masë mund të përfshijë skemat mbështetëse për sektorët industrialë dhe të shërbimeve me potencial të demonstruar për rritjen e eksporteve (p.sh. industria e drurit, turizmi dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit) dhe mund të bazohet në strategjinë e re për zhvillimin e sektorit privat e cila është në përgatitje e sipër.
2. Një masë për të mbështetur inovacionin dhe zhvillimin teknologjik në sektorin privat: Kjo masë duhet të zhvillohet nga Ministria e re e Inovacionit dhe mund të bazohet në masën e inovacionit të prezantuar në PRE në vitin 2018.

Një masë tjetër që mund të merret në konsideratë është mbështetja për zhvillimin e balancuar rajonal. Një grup incentivash specifike për zhvillimin rajonal duhet të kombinohet me një qasje horizontale që merr parasysh faktorin rajonal gjatë zbatimit të skemave të tjera të përgjithshme të mbështetjes për ekonominë ose punësimin, dhe me ndryshime institucionale siç janë decentralizimi fiskal. Për të mbështetur planifikimin dhe zbatimin e masës, ASK duhet të ofrojë statistika të ndara sipas rajoneve për treguesit më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe social.

Sa i përket masave ekzistuese, rekomandohen metodat e mëposhtme:

- Masa 16 për qasjen në financa tashmë ka arritur zbatimin e avancuar dhe tani duhet të rritet me aktivitete për të zhvilluar alternativa ndaj financimit të bankave (p.sh., fondet e kapitalit ndërmarrës dhe të kapitalit fillestar, tregu i ekuitetit, mikrofinancat dhe të ngjashme).
- Masa 17 për NVM-të e grupuara dhe Masa 18 për vlerën e lartë të shtuar të NVM-ve mund të bashkohen dhe shndërrohen në një masë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e NVM-ve, bazuar në përvojën me zbatimin e masave ekzistuese dhe skemave mbështetëse.
- Masa 19 për investimet e IHD-ve dhe të diasporës duhet të vazhdojë dhe të forcohet në mënyrë që të përmirësohen rezultatet.
- Masa 20 për rregullimin e tokës bujqësore mund të bashkohet me Masën 31 mbi infrastrukturën bujqësore dhe të shndërrohen në një masë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorëve konkurrues të bujqësisë dhe të përpunimit të ushqimit.
- Masa 21 për shfrytëzimin e burimeve minerale duhet të vazhdojë.
- Masa 22 për rivitalizimin e Trepçës mund të hiqet pasi që korniza ligjore tani është në fuqi dhe zgjidhjet e dakorduara mund të zbatohen si pjesë e aktiviteteve të rregullta të Qeverisë.
- Masa 23 për Fondin e Privatizimit mund të hiqet pasi që ligji për përdorimin e fondeve të privatizimit është miratuar, por fondet do të drejtohen drejt investimeve kapitale dhe jo në një fond të posaçëm të punësimin dhe rritjes siç ishte parashikuar në SKZH.
- Masa 24 për qeverisjen e ndërmarrjeve shtetërore duhet të vazhdohet.

Tabela 6 ilustron strukturën e re të shtyllës 3, nëse këto rekomandime merren parasysh.

**TABELA 6:** Ristrukturimi i shtyllës 3 me masat e rekomanduara

M15. Rritja e konkurrencës së eksportit të sektorëve industrialë dhe të shërbimeve	Masë e re
M16. Qasja në financa	Masë ekzistuese
M17. Inovacioni dhe zhvillimi teknologjik	Masë e re
M18. Zhvillimi i sektorit konkurrues dhe në rritje të NVM-ve	Bashkimi i masave aktuale 17 dhe 18
M19. Promovimi i IHD-ve dhe rritja e rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik	Masë ekzistuese
M20. Rregullimi i tokës bujqësore	Masa ekzistuese; do të kombinohet me masën aktuale 31
M21. Shfrytëzimi i potencialit mineral të Kosovës	Masë ekzistuese
M22. Qeverisja e mirë dhe performanca e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore	Masë ekzistuese 24
M23. Zhvillimi i balancuar rajonal	Masë e re

#### Shtylla 4 – Infrastruktura: Shtimi i masave për cilësinë e mjedisit dhe përdorimin e gazit natyror

Masat e infrastrukturës energjetike tani janë kryesisht të lidhura me infrastrukturën e energjisë elektrike dhe tregun; këto duhet të plotësohen me një masë për infrastrukturën dhe përdorimin e gazit natyror. Shtylla 4 tashmë përfshin masa për menaxhimin më të mirë të burimeve natyrore (d.m.th. ujit dhe pyjeve) dhe menaxhimin e mbeturinave, por nuk ekziston ndonjë masë e përgjithshme lidhur me cilësinë e mjedisit, pavarësisht nga shqetësimet në rritje të mjedisit. Masat e mëposhtme mund të shtohen:

1. Një masë për ndërtimin e infrastrukturës dhe tregut të gazit natyror: Pasi që Kosova momentalisht nuk ka furnizime me gaz natyror, një studim fizibiliteti për ndërtimin e sistemit të gazit natyror TAP është duke u zhvilluar. Gazi natyror mund të përdoret si për prodhimin e energjisë ashtu edhe për ngrohje. Kjo paraqet një zgjidhje më të përshtatshme ndaj mjedisit krahasuar me termocentralet aktuale, që operojnë me linjit dhe mund të sigurojnë një kapacitet balancimi që punon më shpejt se termocentralet me qymyr. Një rrjet i plotë i gazit natyror do të jetë i kushtueshëm, por sidoqoftë, fillimisht në fokus potencialisht do të ishin termocentralet dhe konsumatorët industrialë.
2. Një masë e përgjithshme për përmirësimin e cilësisë së mjedisit: Kjo masë duhet të përshkruajë zhvillimin e rregulloreve dhe standardeve mjedisore dhe përfshirjen e parimit “ndotësi paguan” në legjislacion. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet përmirësimit të cilësisë së ajrit, rëndësia e së cilës është rritur në vitet e fundit dhe nuk është adresuar nga masat ekzistuese.

Sa i përket masave ekzistuese, rekomandohen metodat e mëposhtme:

- Masa 25 për kapacitetet gjeneruese të energjisë duhet të vazhdojë, ndonëse marrëveshjet kontraktuese me investitorin privat për Kosovën e Re tani po finalizohen. Zbatimi i investimeve duhet të monitorohet nga afër dhe aktiviteti për hapjen e një miniere të re të qymyrit do të zgjasë disa vite për t'u zbatuar plotësisht.
- Masa 26 për tregun e hapur të energjisë duhet të vazhdojë dhe nëse është e nevojshme, të zgjerohet me një aktivitet në tregun e hapur të gazit natyror.
- Masa 27 për eficiencën e energjisë duhet të vazhdojë dhe të përmirësohet me aktivitetet e synuara në sektorin e biznesit rezidencial dhe privat, të zbatuar përmes Fondit për Eficiencë të Energjisë (p.sh., kreditë e buta, subvencionet direkte dhe auditimet e energjisë).
- Masa 28 për burimet e ripërtërishme të energjisë duhet të vazhdojë së zbatuari.
- Masa 29 për rrugët dhe hekurudhat duhet të vazhdojë së zbatuari.
- Masa 30 në infrastrukturën e teknologjisë informative dhe të komunikimit duhet të vazhdojë së zbatuari.
- Masa 31 për infrastrukturën bujqësore mund të bashkohet me Masën 20 mbi tokën bujqësore dhe të shndërrohen në një masë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorëve konkurrues të bujqësisë dhe të përpunimit të ushqimit nën Shtyllën 3.
- Masa 32 për menaxhimin e ujit duhet të vazhdojë së zbatuari.
- Masa 33 për menaxhimin e pyjeve duhet të vazhdojë së zbatuari.
- Masa 34 për menaxhimin e mbeturinave duhet të vazhdojë së zbatuari.

Tabela 7 ilustron strukturën e re të Shtyllës 4, nëse këto rekomandime merren parasysh.

**TABELA 7:** Ristrukturimi i Shtyllës 4 me masat e rekomanduara

M24. Infrastruktura dhe shfrytëzimi i gazit natyror	Masë e re
M25. Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike dhe energjia e qëndrueshme	Masë ekzistuese
M26. Krijimi i një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike	Masë ekzistuese
M27. Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të eficiencës	Masë ekzistuese
M28. Shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtërishme të energjisë	Masë ekzistuese
M29. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore	Masë ekzistuese
M30. Shtrirja e infrastrukturës së teknologjisë informative	Masë ekzistuese
M31. Përmirësimi i cilësisë së mjedisit	Masë e re
M32. Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapaciteteve për menaxhimin e ujërave	Masë ekzistuese
M33. Shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	Masë ekzistuese
M34. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave	Masë ekzistuese

## SHTOJCA I.

## TABELA E MONITORIMIT STRATEGJIK

NDS 2016–2021				
Nr.	Masa	Zbatimi	Afati kohor	Rezultatet
1	Gjithëpërfshirja në arsimin parashkollor dhe parafillor	HS	OT	WP
2	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar	HS	WD	ND
3	Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës	HS	OT	LP
4	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	HS	WD	LP
5	Optimizimi i shpenzimeve në arsim nëpërmjet sistemeve të të dhënave	HS	OT	WP
6	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës	HS	WD	ND
7	Adresimi i punësimit joformal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë	HS	OT	NP
8	Përmirësimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve të përqendruara tek konsumatorët për bizneset dhe publikun	HS	OT	WP
9	Zvogëlimi i pengesave administrative për licencat dhe lejet	HS	OT	WP
10	Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të inspektimeve	HS	WD	ND
11	Inkurajimi i politik-bërjes së bazuar në të dhëna	HS	WD	NP
12	Mbyllja e hapësirave për abuzime në sistemin e prokurimit publik	ADV	OT	ND
13	Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore	HS	WD	WP
14	Rritja e efikasitetit të gjyqësorit	ADV	OT	WP
15	Lufta kundër joformalitetit përmes krijimit të një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave	NS	WD	WP
16	Rritja e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	ADV	OT	LP

17	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	ADV	OT	WP
18	Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	HS	OT	ND
19	Promovimi i investimeve të huaja direkte (IHD) dhe rritja e rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik	HS	OT	LP
20	Rregullimi i tokave bujqësore	HS	OT	WP
21	Shfrytëzimi i potencialit mineral të Kosovës	HS	OT	AP
22	Ristrukturimi dhe rivitalizimi i Trepçës	HS	WD	NP
23	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	HS	OT	
24	Qeverisja e mirë dhe performanca e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore	HS	OT	NP
25	Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike dhe energjia e qëndrueshme	HS	WD	AO
26	Krijimi i një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike	HS	OT	AO
27	Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të efijencës	HS	WD	ND
28	Shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtërishme të energjisë	HS	WD	ND
29	Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore	ADV	OT	ND
30	Shtrirja e infrastrukturës së teknologjisë informative	HS	WD	AP
31	Infrastruktura bujqësore në funksion të agro-biznesit	ADV	OT	ND
32	Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapacitetit të burimeve ujore	HS	WD	WP
33	Shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	HS	WD	ND
34	Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave	HS	WD	LP

## SHTOJCA II.

## TABELA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT

Shtylla 1 - Kapitali njerëzor				
M	A	Aktiviteti	Zbatimi	Afati kohor
1	1	Rritja e numrit të kopshteve publike	HS	OT
	2	Rritja e përfshirjes në institucione private	HS	OT
	3	Optimizimi i personelit mësimdhënës përmes rialokimit prej niveleve më të larta (arsimit fillor).	HS	OT
2	1	Rishikimi dhe përfundimi i procesit të kualifikimit të mësimdhënies para futjes në shërbim	NS	WD
	2	Optimizimi i numrit të mësimdhënësve ekzistues duke e pasur për kriter cilësinë	HS	OT
	3	Përsheptimi i procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve	ADV	OT
	4	Zgjerimi i përdorimit të kurrikulës së re në të gjitha shkollat e mbetura	HS	OT
	5	Rishikimi i teksteve ekzistuese si dhe zhvillimi i teksteve të reja	HS	MV
3	1	Përsheptimi i procesit të zhvillimit të standardeve profesionale	ADV	OT
	2	Përcaktimi i fushave me prioritet më të lartë në AAP, si dhe zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave bërthamë	HS	OT
	3	Zbatimi i sistemit pilot i kombinuar i AAP-së me elemente të mësimit të dyfishtë	HS	OT
	4	Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar i Parashikimit të Nevojave për Shkathtësi	NS	WD
	5	Ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë përmes qasjes së specializime dhe investime në hulumtime dhe zhvillim	HS	OT
4	1	Rritja e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Cilësisë	HS	OT
	2	Zbatimi i një sistemi më të besueshëm të provimit final për nxënës	HS	OT
	3	Përmirësimi i provimit final për profesionet e rregulluara	NS	WD
	4	Zgjerimi dhe përmirësimi i sistemit të inspektimeve në sistemin arsimor edhe aspekteve të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve	ADV	OT
	5	Përmirësimi i cilësisë së autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve të akredituara	HS	WD
	6	Zhvillimi i një sistemi të vlerësimit të suksesit të mësimdhënies si dhe një sistem të gradimit të mësimdhënësve	HS	WD

5	1	Ndërtimi i një master plani për rrjetin shkollave të AAP-së	NS	WD
	2	Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL)	ADV	OT
	3	Rritja e financimit për programet e arsimit profesional dhe arsimit të lartë	HS	OT
	4	Pilotimi i modelit të Partneriteteve Publiko-Private	HS	OT
6	1	Krijimi i një baze të të dhënave e cila përdorë regjistrin e diasporës për identifikimin e profileve të ndryshme të mërgatës	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	2	Krijimi i Programit për Angazhim në Atdhe (PAA)	HS	WD
	3	Kosova do të bëhet pjesë e Programit për Kthimin e Ekspertëve të Qeverisë së Gjermanisë në vitin 2016	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	4	Kosova dhe UNV (Programi i Kombeve të Bashkuara për Vullnetarë) do të zbatojnë programin TOKTEN	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	5	Zhvillimi i një programi mësimor online (e-learning)	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
7	1	Forcimi i dialogut të institucioneve me partnerët social	HS	OT
	2	Përmirësimi i të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i minimumit të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë	HS	OT
	3	Përforcimi i mekanizmave dhe bashkërendimi i veprimeve institucionale për zvogëlimin e punësimit joformal	HS	OT
	4	Krijimi i sistemit për menaxhimin e informatave në Inspektoratin e Punës	IA	WD

Shtylla 2: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit

M	A	Aktiviteti	Zbatimi	Afati kohor
8	1	Krijimi i një regjistri të të gjitha shërbimeve publike	IA	OT
	2	Krijimi i një baze qendrore të të dhënave për shërbimet publike	ADV	OT
	3	Vendosja e një sistemi të freskimit të rregullt të informatave lidhur me ofrimin e shërbimeve	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	4	Harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit për shërbime	HS	OT
9	1	Krijimi i një regjistri të të gjitha procedurave të veçanta administrative	ADV	OT
	2	Vendosja e një sistemi për shqyrtimin dhe miratimin e të gjitha procedurave administrative	HS	OT
	3	Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave administrative	HS	OT
	4	Adaptimi i qasjes “gijotinë” për të shkurtuar numrin dhe për të harmonizuar listën e licencave ekzistuese	HS	OT
	5	Zbatimi i plotë i regjistrimit online të të gjitha lejeve dhe licencave dhe sigurimi se ato që nuk janë të përfshira në regjistër do të jenë të pavlefshme	HS	OT
	6	Zbatimi i plotë i regjistrimit online të të gjitha lejeve dhe licencave dhe sigurimi se ato që nuk janë të përfshira në regjistër do të jenë të pavlefshme	HS	MV
10	1	Miratimi i një ligji të harmonizuar lidhur me inspektimet	HS	MV
	2	Vlerësimi i të gjitha inspektimeve, i pasuar me eliminimin e aktiviteteve të panevojshme ose shkrirjen e aktiviteteve inspektuese aty ku ka hapësirë	HS	WD
	3	Krijimi i një mekanizmi koordinues mes trupave inspektues, duke e përfshirë këtu krijimin e një sistemi informativ për shkëmbimin e informatave ndërmjet inspektorateve	HS	OT
11	1	Krijimi i një njësie institucionale për VNR si dhe njësi brenda ministrive të linjës	HS	WD
	2	Zbatimi i Strategjisë për Rregullim më të Mirë	HS	OT
	3	Krijimi i një mekanizmi për mbledhjen dhe ruajtjen sistematike	NS	WD
	4	Përdorimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe i komiteteve ad-hoc	HS	OT



12	1	Zbatimi i ligjit të ndryshuar dhe rregulloreve ekzistuese në fushën e prokurimit publik	ADV	OT
	2	Përhshpejtimi i zbatimit të platformës elektronike të prokurimit publik	HS	OT
13	1	Zhvillimi i kornizës ligjore për të drejtat komerciale të pronës	HS	OT
	2	Promovimi i tregut të tokës	HS	OT
	3	Fuqizimi i kapaciteteve dhe rolit të gjykatave në të drejtat pronësore	NS	WD
	4	Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave përkatëse pronësore të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, si dhe sigurimi i të drejtave pronësore për gratë	HS	WD
14	1	Ndryshimi i kornizës ligjore	ADV	OT
	2	Stimulimi i pagesave të hershme të gjobave të kundërvajtjeve	IA	OT
	3	Shkarkimi i sistemit gjyqësor nga rastet e grumbulluara përmes krijimit të një ekipi special prej 100 personash	ADV	OT
	4	Ruajtja e një norme pozitive e pastrimit të rasteve të grumbulluara përmes optimizimit të sistemit të menaxhimit të rasteve	ADV	OT
15	1	Veprimet e nevojshme për të arritur konvergjencën graduale të proceseve dhe integrimin pasues të dy institucioneve	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	2	Themelimi i Agjencisë për mbledhjen e të hyrave	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	

Shtylla 3: Industritë konkurruese

M	A	Aktiviteti	Zbatimi	Afati kohor
16	1	Operacionalizimi i skemave për garantimin e kredive	ADV	OT
	2	Vlerësimi i operimit të skemës dhe shqyrtimi i mundësive për zgjerim të mëtutjeshëm dhe optimizim të skemës	ADV	OT
	3	Integrimi i bazës së të dhënave të sistemit të regjistrimit të kredive me administratën tatimore	ZB	OT
	4	Krijimi i lehtësirave speciale për Skemën Vauçer	HS	OT
17	1	Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare të Konkurrueshmërisë	ADV	OT
	2	Krijimi i një kornize institucionale në mbështetje të zhvillimit të grupimeve industriale	AVA	OT
	3	Krijimi i rrjetit të furnizuesve dhe nën-kontraktorëve	AVA	OT
18	1	Krijimi i një instrumenti për të ndihmuar në certifikimin e standardeve të cilësisë për ndërmarrjet kosovare	HS	OT
	2	Krijimi i një skeme për mbështetjen e inovacionit	HS	OT
	3	Krijimi i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor	ADV	OT
19	1	Fuqizimi i kapaciteteve të KIESA dhe riorganizimi i saj	HS	OT
	2	Mbështetja e investimeve të investitorëve strategjikë	HS	OT
	3	Krijimi i skemave të granteve korrespondente për diasporën	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	4	Aktivizimi dhe zgjerimi i rrjeteve të bizneseve të diasporës	HS	OT
	5	Bashkëpunimi në mes të rrjeteve të bizneseve të diasporës si dhe institucioneve të vendit	HS	OT
20	1	Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës	HS	WD
	2	Ndërmarrja e reformave strukturore	HS	OT
	3	Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike	ADV	OT
	4	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore	HS	OT
21	1	Krijimi i modaliteteve institucionale për të mbështetur (përmes financimit apo asistencës teknike) projekte të reja strategjike në sektorin minerar	ADV	OT
	2	Mbështetja e programeve kërkimore gjeologjike dhe minerare	HS	OT
	3	Rregullimi i tregut të kërkimeve dhe zhvillimit të projekteve përmes forcimit të kapaciteteve administrative të organeve mbikëqyrëse dhe agjencive ekzekutive	HS	OT
	4	Ofrimi i mbështetjes për të zhvilluar infrastrukturën përcjellëse për sektorin minerar	ADV	OT

22	1	Studimi final i fizibilitetit	IA	OT
	2	Hartimi i koncept dokumentit i bazuar në studimin e fizibilitetit	HS	OT
	3	Rregullimi i çështjeve rreth asetëve dhe bizneseve të paqëndrueshme për rivitalizim	NS	WD
	4	Vendosja për rritjen e afarizmit/prodhimit industrial të mëtejme të Trepçës	ADV	OT
23	1	Vlerësim i pavarur i mjeteve në dispozicion dhe vendimarrja mbi përdorimin e mjeteve	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	2	Zhblllokimi i fondit dhe krijimi i mekanizmave për shpenzimin e mjeteve	IA	OT
	3	Zbatimi i projekteve dhe nismave konkrete duke i përdorur mjetet nga Fondi i Privatizimit	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
24	1	Shqyrtimi i opsioneve për qasje sektoriale në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e korporatave në pronësi publike nga pronari	ADV	OT
	2	Zhvillimi i proceseve dhe analizave të rrezikut nga ndërmarrjet shtetërore	HS	OT
	3	Trajnimi i zyrtarëve në sektorët/dikasteret përkatës në qeverisje korporative	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	4	Futja e sistemit MBO (Menaxhmenti sipas Objektivave)	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	5	Shqyrtimi i mundësive për eliminimin e burokracisë dhe ndikimit në ndërmarrjet komerciale që operojnë në tregje konkurruese	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	

Shtylla 4: Infrastruktura				
M	A	Aktiviteti	Zbatimi	Afati kohor
25	1	Zgjatja e procesit të dekomisionimit të TC Kosova A	NS	WD
	2	Rehabilitimi i TC Kosova B	ADV	OT
	3	Ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re	HS	OT
	4	Zbatimi i reformave strukturore në KEK	HS	WD
	5	Hapja e minierës së re të thëngjillit (Sibofci Jugor)	HS	OT
26	1	Integrimi i tregut të energjisë me tregun rajonal të energjisë	HS	OT
	2	Ndërtimi i linjës së transmisionit 400 KV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë	ZB	OT
27	1	Krijimi i Fondit për Eficiência të Energjisë	HS	OT
	2	Fillimi i zbatimit të praktikës së kontratave të performancës për kursimit të energjisë	HS	WD
	3	Zgjerimi i rrjetit të ngrohtores	HS	OT
28	1	Rishikimi dhe negociimi i caqeve më të ulëta për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë	ADV	OT
	2	Analiza e studimit të fizibilitetit të Hidrocentralit të Zhurit	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	3	Mundësimi i kontratave afatgjata për fermerë që të shfrytëzohen mbetjet organike si dhe sigurimi i organizimit më të mirë i tregut të mbetjeve të drurit dhe malore	HS	MV
29	1	Finalizimi i segmentit të mbetur të autostradës Morinë – Merdar (R7)	ADV	OT
	2	Përfundimi i ndërtimit të autostradës Prishtinë – Han i Elezit (R6)	ADV	OT
	3	Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale Prishtinë – Pejë (M9) dhe Prishtinë – Mitrovicë (M2)	ADV	OT
	4	Zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë - Podujevë	ADV	OT
	5	Zgjerimi i rrugëve nacionale Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren	HS	OT
	6	Ndërtimi i autostradës Prishtinë – Gjilan – Dheu i bardhë	HS	OT
	7	Modernizimi i linjës ndërkombëtare hekurudhore Linja 10	HS	OT
30	1	Krijimi i Këshillit Nacional për TI	ZB	OT
	2	Mbështetja e bizneseve kosovare të fushës së TI	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	3	Miratimi i standardeve ndërkombëtare përkatëse të TIK-ut	HS	WD
	4	Zbatimi i Programit për Ekonominë Digjitale të Kosovës	HS	OT

31	1	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes	HS	OT
	2	Rritja e numrit të objekteve të deponimit	ZB	OT
	3	Rritja e numrit të njësive laboratorike	ADV	OT
	4	Rritja dhe përmirësimi i strukturave të fermave, si dhe rritja e kapaciteteve përpunuese të industrisë ushqimore	ADV	OT
	5	Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të informatave	ADV	OT
32	1	Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale	HS	OT
	2	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të ri	HS	WD
	3	Realizimi i studimit të fizibilitetit për lokacionet e mundshme për ndërtimin e akumulimit të ujërave sipërfaqësore	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	4	Dizajnimi i projektit për ndërtimin e sistemit ujqor “Ibër-Lepenc”	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	5	Investimi në zgjerim dhe rritje të efijencës të sistemeve të ujitjes	HS	OT
	6	Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse	HS	
	7	Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm	HS	WD
33	1	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura pyjore, rimëkëmbja e pyjeve të dëmtuara nga zjarri	HS	WD
	2	Ndërmarrja e masave më të ashpra kundër prerësve ilegalë	HS	OT
	3	Zhvillimi i planeve për menaxhimin e pyjeve	HS	OT
34	1	Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave komunale, të ngurta, të ndërtimit, industriale dhe të rrezikshme dhe të lymit nga ujërat e ndotura	NS	WD
	2	Konsolidimi i kompanive publike për mbledhjen e mbeturinave si dhe kontraktimi i operatorëve ekonomikë përmes partneriteteve publiko-private	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	3	Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe reduktimi gradual i sasisë së mbeturinave	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	4	Implementimi i projekteve për zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore nga mbeturinat	Nuk është planifikuar të zbatohet gjatë periudhës raportuese	
	5	Riparimi dhe ndërtimi i rrjeteve grumbulluese për ujërat e ndotura	HS	OT
	6	Ndërtimi i stacionit bartës dhe qendrës për mbledhjen e mbeturinave	NS	WD
	7	Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operuese në deponinë e rajonit të Prishtinës në Mirash/Obiliq	NS	WD

## Evaluation criteria for the progress of implementation of activities and respective codes

### Timeframe

Code	Status	Evaluation on the sub-activity level	Evaluation on the activity level
OT	On time.	Sub-activity is being implemented according to the timeline planned in the Roadmap.	Most of the sub-activities are being implemented according to the timeline planned in the Roadmap.
WD	With delays.	At least 2 sub-activities are not being implemented according to the timeline planned in the Roadmap, since it has not started yet or started a year later from the planned time.	Sub-activity is not implemented according to the timeline planned in the Roadmap, since it has not started yet or started a year later from the planned time.

### Implementation rate

Code	Status	Evaluation on the sub-activity level	Evaluation on the activity level
NS	Not Started.	None of the sub-activities has started.	It has not started.
HS	Has started.	Sub-activity is being implemented but indicators have not yet been achieved.	Sub-activities are being implemented but indicators have not yet been achieved.
ADV	Advanced.	Performance is good and a good part of the indicators are achieved.	Performance is good and a good part of the indicators are achieved.
IA	Implemented activity.	The planned output is realized.	All the planned outputs have been realized.

Results	
ND	No Data
NP	No Progress
LP	Limited Progress
WP	With Progress
AP	Advanced Progress
AO	Accomplished Objective

## SHTOJCA 3.

# DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE PËR OZHQ-TË DHE CAQET E HARMONIZUARA ME SKZH

Shtyllat e SKZH:	1. MIRESI E SHËNDRITIA	2. MIRESI E MIRETËSIA	3. SHËNDRITIA DHE QENDRUESHMËRIA	4. QENDRUESHMËRIA DHE EKUIDADË	5. MIRESI E MIRETËSIA	6. MIRESI E MIRETËSIA	7. MIRESI E MIRETËSIA	8. MIRESI E MIRETËSIA	9. MIRESI E MIRETËSIA	10. MIRESI E MIRETËSIA	11. MIRESI E MIRETËSIA	12. MIRESI E MIRETËSIA	13. MIRESI E MIRETËSIA	14. MIRESI E MIRETËSIA	15. MIRESI E MIRETËSIA	16. MIRESI E MIRETËSIA	17. MIRESI E MIRETËSIA
1. Kapitali njerëzor				3													
2. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit		1															
3. Industritë konkurruese					3	1											
4. Infrastruktura						1	1										1
Treguesit e nivelit të lartë								3									

\* Numrat e paraqitur nën secilin objektiv përfaqësojnë numrin e caqeve të OZHQ të harmonizuar për secilin shtyllë specifike të SKZH dhe treguesin e nivelit makroekonomik të SKZH

### Legjenda e tabelës:

 Nuk ka harmonizim të OZHQ me SKZH

 Të dhëna pjesërisht të raportuara për caqet e OZHQ

 Nuk ka të dhëna të raportuara për caqet e OZHQ

 Të dhëna të raportuara për caqet e OZHQ